



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT
PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT :

1. Peçi NAQELLARI
2. Eda ÇELA
3. Teuta TOSKA
4. Artan SPAHIU
5. Ardian TANA
6. Zamira ÇABIRI
7. Albana PISHA

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar


Anëtar

Anëtar (Student)

Data: 23/04/2020


Përmbajtja

1. Hyrje në procesin e vetëvlerësimit.....	1
2. Historiku i UE “Aleksandër Xhuvani”.....	2
3. Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për akreditimin institucional.....	4
1 - Fusha e vlerësimit: Organizimi dhe menaxhimi i institucionit.....	5
2 - Fusha e vlerësimit: Burimet.....	12
3 - Fusha e vlerësimit: Kurrikula.....	19
4 - Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi.....	25
5 - Fusha e vlerësimit: Studentët dhe mbështetja e tyre.....	32
Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm.....	38
4. Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së UE “Aleksandër Xhuvani”.....	39



Lista e Shkurtimeve**EMËRTIMI****SHKURTIMI**

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	UE
Fakulteti i Shkencave Humane	FSHH
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	FSHN
Fakulteti i Shkencave të Edukimit	FSHE
Fakulteti Ekonomik	FE
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	FSHMT
Institucion i Arsimit të Lartë	IAL
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	MASR
Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	NJSBC
Master Profesional	MP
Master i Shkencave	MSH
Life Long Learning	LLL
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Kontrolli i Lartë i Shtetit	KLSH
Grup i Vlerësimit të Brendshëm	GVB
Raport i Vetëvlerësimit të Brendshëm	RVB
Bashkimi Evropian	BE



1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, është realizuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 126 datë 17.03.2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë përvlerësimin dhe akreditimin institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, si dhe Manualit për “Procedurat dhe afatet përvlerësimin e Cilësisë në Kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”. Raporti është hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, i krijuar me Urdhër të Rektorit të UE-së, Nr. 616 prot, datë 03.03.2020 “Për krijimin e grupit të punës përhartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional”.

Në përgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kriterë si kompetenca profesionale, paanshmëria e anëtarëve, mundësitë e komunikimit dhe mbledhjes së informacionit, përfaqësimi në grup i sa më shumë opinioneve të njësive përbërëse të UE-së si dhe kujtesa historiko-institucionale. GVB ka në përbërje të tij përfaqësues të seciliës njësi kryesore të UE-së, përfaqësues të njësive të tjera të UE-së si dhe përfaqësues të studentëve.

Strukturat të cilat kanë bashkëpunuar më afér me GVB janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përherëshëm Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë si dhe Komisioni Institucional për Mbrojtjen e Studentëve. Këto struktura, të krijuara e të organizuara sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, që nga momenti i krijimit të tyre, kanë asistuar dhe kanë bashkëpunuar me GVB.

GVB në hartimin e raportit ka patur si qëllim të përshkruajë e të evidentojë përmbytjen e standardeve të cilësisë, referuar edhe përmbytjes së rekomandimeve sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.8 datë 07.04.2017 “Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, gjatë periudhës 2016-2020.

Raporti është organizuar dhe realizuar sipas fushave të vlerësimit si më poshtë:

- Organizimi dhe menaxhimi i institucionit;
- Burimet;
- Kurrikula;
- Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi;
- Studentët dhe mbështetja e tyre.

Pas hartimit, rapporti u diskutua në çdo njësi, duke marrë sugjerime, të cilat u reflektuan në hartimin e dokumentit përfundimtar.

2. Historiku i IAL

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i themeluar në vitin 1991, është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, një nga universitetet më të rinj në fusha të ndryshme të studimeve. Historia e tij për afro 4 dekada ka njojur arritje të dukshme në shumë fusha të veprimtarisë së procesit mësimor dhe kërkimor. Universiteti është ngritur mbi një traditë të pasur në këtë drejtim. Pa dyshim kjo traditë ka të bëjë dhe është e lidhur ngshtë me Shkollën Normale, të celur më 1909, e cila luajti për shumë kohë rolin e një universiteti të vërtetë.

Sot, Universiteti i Elbasanit, vazhdon traditën arsimore në fushën e mësuesisë por dhe në fusha të reja e dinamike të dijes e kërkimit shkencor. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UE-së si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:

I. Fakulteti i Shkencave Humane, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoratë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe dhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji, programe profesionale 2-vjeçare në sekretar i specializuar dhe operator turistik në gjuhën gjermane.

II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedisi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale si dhe programe profesionale 2-vjeçare në teknik laboratori, teknik mjedisi, mekatronikë, logistikë .

III. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me programe studimi Bachelor, Master profesional në fushat e kërkimit të tij: mësuesi për ciklin fillor (klasës I-IV të shkollës 9-vjeçare), edukatorë për arsimin parashkollar, psikologji, filozofi, sociologji, edukim fizik dhe artistik si dhe program profesional 2-vjeçar në edukator për moshat 0-3 vjeç.

IV. Fakulteti Ekonomik, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: administrim, biznes, financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, shkenca juridike në biznes, shkenca juridike në sektorin publik, ekonomi turizëm, administrim biznes dhe inxhinieri dhe informatikë ekonomike.

V. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: infermieri, infermieri mami, teknik laboratori, imazheri, manazhim infermieror, fizioterapi dhe logopedi.

Që nga themelimi i UE-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore. Si kërkesa të natyrshme të ristrukturimit të UE-së dhe si ndihmëse në procesin e mësimdhënies, janë ngritur e janë vënë në dispozicion laboratorë teknikë pranë secilës njësi kryesore.

Bashkërendimi i orëve teorike në të gjitha programet e studimit me orët e praktikës në laboratorë apo pranë institucioneve bashkëpunëtore të UE-së, ka krijuar një ridimensionim të hapësirës së studentit. Politikat institucionale me në qendër studentin, kanë krijuar hapësira të pafundme për ndërkombëtarizimin e UE-së, duke u ofruar studentëve mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në programet e mobilitetit jashtë vendit. Gjithashtu kjo politikë është integruar me partneritete brenda dhe jashtë vendit, për të realizuar trajnime e kualifikime të ndryshme.

Politika e ndërkombëtarizimit ka patur një shtrirje të gjerë mes personelit të UE-së. Kjo ka mundësuar shkëmbime të personelit me universitetet partnere si dhe ka nxitur e kontribuar në rritjen e kapaciteteve, në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve të Bashkimit Evropian. Kjo ka sjellë si pasojë një sërë aktivitetesh ndërkombëtare në UE.

Koncepti për të ardhmen e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mbështetet jo thjesht në afërsinë e tij pranë tregut të punës, transaksioneve dhe sferës utilitare, por, pse jo, edhe i shkëputur prej tyre, pasi misioni i universiteteve nuk duhet të jetë vetëm që të prodhojë punëtorët dhe specialistët e fushave të ndryshme të kulturës dhe prodhimit, por edhe të formojë mbrojtës dhe sigurues të lirive e të drejtave shoqërore dhe qytetare në Shqipëri.

3

3. Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

Në momentin e paraqitjes së raportit të vetëvlerësimit të IAL-së, lutemi referojuni Fushave të Vlerësimit për Akreditimin institucional dhe të gjithë standardeve të parashikuara në Shtojcën 4¹(*)

Shtjellimi përkundrejt çdo standardi do të ndihmojë GVB të vlerësojë se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbrush standardet. Grupi i vlerësimit të brendshëm duhet të paraqesë tekst përshkruesi IAL i përmbrush standardet, me referencë në evidencat përkatëse. Vlerësimi duhet të mbështetet me fakte dhe evidenca si dhe i shoqëruar me dokumentacionin e përkthyer në anglisht, sipas listës së paraqitur në Shtojcën 6.

Në fund të tekstit, për çdo fushë vlerësimi, GVB duhet të konkludojë, duke cituar vlerësimin përkatës, se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbrush standardet për atë fushë, duke deklaruar nëse standardet përbushen plotësisht, kryesisht, pjesërisht ose nuk përbushen. Udhëzimet e mëtejshme mbi gjykimin përkundjet fushave të vlerësimit, gjenden në Shtojcën 11.

Bazuar në gjykimet për çdo fushë vlerësimi, GVB do të konkludojë/arrijë në gjykimin e përbledhur të vetëvlerësimit, duke identifikuar dhe parashikuar masat që do të ndërmerrin nga IAL-ja për përmirësimin në vijim. Më tepër detaje për gjykimin e përbledhur gjenden në Shtojcën 6.

Aty ku parashikohet dokumentacion mbështetës, duhet të referohet në tekst dhe/ose të lidhet me adresën përkatëse web. Të gjitha dokumentet mbështetëse të referuara dhe/ose lidhura me adresën ëeb duhet të paraqiten si pjesë e dokumentacionit të vetëvlerësimit.

¹ (*) Standardet Institucionale shtetërore të Cilësisë janë aprovuar me UMASH Nr. 126, datë 17.03.2011. ASCAL vazhdon të zbatojë këto standarde, bazuar në Nenin 138 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"

1 – FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

Autonomia

Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit. (Kreu III Standardi I.1)

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” iu nënshtrua organizimit dhe përditësimit të akteve të brendshme. Për këtë arsy, u ngrit një grup pune, të cilit iu ngarkua detyra e hartimit të Statutit të UE-së (në vijim Statuti), për ta kaluar propozimin për mendime nga të gjitha strukturat e UE-së. Propozimi, pasi u diskutua, u miratua paraprakisht nga Bordi i Administrimit të UE-së, Senati Akademik i UE-së (në vijim Senati), u dërgua për miratim në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR). Përfundimisht, me Urdhërin e MASR-së Nr 144 datë 26.03.2018, “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, u miratua dhe hyri në fuqi Statuti i UE-së. (EVIDENCA 1.1).

Statuti është dokumenti bazë i veprimitarisë së Universitetit. Në të janë parashikuar elementet më të rëndësishme të organizimit dhe funksionimit të UE-së si dhe shërben si akti referues për miratimin e akteve të tjera të brendshme të institucionit. Aktet e tjera të dala në zbatim të Statutit janë rregulloret e organeve kolegiale, rregulloret institucionale, rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë. Këto akte, pas miratimit, i vihen në dispozicion strukturave si dhe publikohen në faqen web të UE-së, <http://uniel.edu.al/index.php/al/statuti-dhe-rregullorja>

Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efiçencë në menaxhim. (Kreu III Standardi I.2)

Organi më i lartë drejtues akademik i UE-së është Senati Akademik, ndërsa organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Bordi i Administrimit të Universitetit të Elbasanit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme, 4 (katër) anëtarë janë të emëruar nga ministria përgjegjëse për arsimin (EVIDENCA 1.2), ndërsa 3 (tre) prej tyre janë anëtarë të personelit akademik të UE-së, të emëruar nga Senati Akademik i UE-së, për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. (EVIDENCA 1.3).

Bordi i Administrimit i UE-së ka miratuar rregulloren e tij të funksionimit (EVIDENCA 1.4); (EVIDENCA 1.5). Në përbushje të funksioneve të tij, Bordi i Administrimit të UE-së ka miratuar modalitetet e zgjedhjes së Administratorit të UE-së, zgjedhje e cila është bërë me procedurë publike konkurrimi. Bordi i Administrimit ka zgjedhur dhe emëruar Administratorin e UE-së, sipas vendimit të Senatit për miratimin e listës së kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret. (EVIDENCA 1.6).

Veprimitaria e këtyre dy organeve (Senatit dhe Bordit) bashkërendohet, në zbatim të ligjit, në

kuadër të mirëmenaxhimit të UE. Strukturat e Rektoratit të UE-së përgatisin materialet dhe relacionet e projektvendimeve apo akteve, për mbledhjen e organeve përkatëse.

Me propozim të Senatit, Bordi i Administrimit miraton strukturën dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet në UE. (**EVIDENCA 1.7**).

Senati miraton veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore vjetore, sipas projekt raportit të Rektoratit, ndërsa Bordi i Administrimit miraton veprimtarinë ekonomike vjetore, sipas projekt raportit të Rektoratit. Të dyja këto struktura miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë së UE-së dhe ia dërgojnë MASR-së. (**EVIDENCA 1.8**) Procedura e miratimit të projektbuxhetit dhe buxhetit të UE-së i nënshtrohet fillimi si paraprak të Senatit e më pas i dërgohet për vendimmarrje Bordit të Administrimit. (**EVIDENCA 1.9**).

Bordi i Administrimit përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit, bazuar edhe në propozimet e Senatit. (**EVIDENCA 1.10**).

Institucioni favorizon debatin konstruktiv. (Kreu III Standard I.3)

Debati konstruktiv është një element shumë i rëndësishëm për vendimmarrjen e organeve drejtuese të UE-së. Favorizimi i tij, realizohet duke patur parasysh elementin e periodicititetit të mbledhjeve të strukturave akademike dhe administrative, si dhe konsultimin paraprak të materialev, para diskutimit dhe procesit vendimmarrës. Senati, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati, Departamentet, Qendrat, Komisionet e ngritura mblidhen në mënyrë periodike, të paktën një herë në muaj. (**EVIDENCA 1.11**).

Përpara çdo mbledhjeje, materialet për diskutim përgatiten dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të këtyre strukturave përpara marrjes së vendimeve, në mënyrë që ato të kenë kohën e domosdoshme që të konsultohen me materialet dhe të reflektojnë për vendimet që do të merren. Këto procedura janë të parashikuara në aktet e funksionimit të organeve vendimmarrëse.

Pjesë e debatit konstruktiv janë edhe studentët, të organizuar në disa forma:

-Si studentë të zgjedhur, përfaqësues në Senat. (**EVIDENCA 1.11**).

-Si studentë të zgjedhur dhe përfaqësues në Këshillin e Studentëve, në nivel fakulteti dhe në nivel institucioni. (**EVIDENCA 1.12**).

-Si studentë përfaqësues, anëtarë të komisioneve të përhershme në nivel institucioni apo komisioneve në nivel fakulteti, ku studentët janë anëtarë me të drejta të plota. (**EVIDENCA 1.13**)

Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij. (Kreu III Standardi I.4)

UE i përbahet kufijve të kësaj autonomisë së përcaktuar me ligj.

Autonomia financiare në UE, sigurohet nëpërmjet autonomisë për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëpërmjet përcaktimit të tarifave të studimit, Administrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me misionin e tyre. (**EVIDENCA 1.14**). Përveç vetëfinancimit, autonomia financiare sigurohet edhe nëpërmjet përfitimit të fondeve nga shteti (**EVIDENCA 1.15**) dhe organizma të tjera, që në rastin e UE-së, janë projektet e finansuara nga BE, nëpërmjet

⁶

aplikimit të projekteve. (**EVIDENCA 1.16**) UE ka caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit. (**EVIDENCA 1.9**)

Liria akademike dhe autonomia, përmban autonominë për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuar. (**EVIDENCA 1.17**). Autonomia akademike e UE-së konsiston edhe në autonominë për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore. (**EVIDENCA 1.18**). Gjithashtu, në kuadër të autonomisë akademike, UE ka organizuar procesin e promovimit të personelit akademik, duke vlerësuar veprimtarinë e tyre. (**EVIDENCA 1.19**).

Autonomia organizative në UE, lidhet me autonominë për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme. Zgjedhjet organizohen sipas rregullores përkatëse. (**EVIDENCA 1.20**). UE cakton kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit. (**EVIDENCA 1.21**).

Institucioni harton një strategji zhvillimi. (Kreu III Standardi I.5)

UE ka hartuar dhe zbaton strategjinë e zhvillimit të saj. (**EVIDENCA 1.22**) Ky dokument është paraprirë nga një diskutim i gjerë, nga organet dhe autoritetet drejtuese të tij. Strategja synon zhvillimin e ndërkombëtarizimin e institucionit, nëpërmjet shkëmbimit të vlerave dhe aftësive të personelit akademik dhe studentëve. Strategja synon rritjen e pjesëmarrjes efektive të studentëve në vendimarrjen e organeve drejtuese të UE-së, realizimin gjithnjë e më shumë të aktiviteteve mbështetëse të karrierës studentore. Zhvillimi i aftësive të mësimdhënies së personelit akademik është shpallur si premisë kyçë për të siguruar cilësinë e të nxënët te studentët, në atë nivel që ata të demonstrojnë aftësitë dhe kompetencat e duhura që rrisin mundësitet e tyre për punësim në një ekonomi tregu që bëhet përherë dhe më konkurruese, duke rritur autoritetin e diplomës në tregun e punës. Strategja e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si institucion i arsimit të lartë, përcaktuar në Ligjin për Arsimit e Lartë dhe në Statutin e UE-së.

Institucioni publikon reportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe para personelit akademik e studentëve. (Kreu III Standardi I.6)

Raporti vjetor i veprimtarisë së institucionit, është dokumenti i cili përbledh veprimtarinë vjetore akademike dhe veprimtarinë vjetore financiare; ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, për vetë faktin se përmban një analizë të hollësishme. (**EVIDENCA 1.8**) Dokumenti përfundimtar bazohet në raportet e veprimtarisë akademike të njësive kryesore si dhe njësive të tjera përbërëse të UE-së. Dokumenti diskutohet edhe miratohet në mbledhjet e Rektoratit, Senatit dhe Bordit të Administrimit. Dokumenti i dërgohet MASR-së si dhe publikohet në faqen zyrtare të UE-së.

Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (Kreu III Standardi II.1)

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si institucion i arsimit të lartë ka për mision të



krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Mision i UE-së është dhe ofrimi i mundësive të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. Në këtë mënyrë, mision i UE-së është kontribuimi në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, duke mbështetur prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.

UE, në mbështetje të dispozitave ligjore, është e organizuar në njësi kryesore (fakultet), njësi bazë (departamentet /qendra kërkimore) si dhe njësi të tjera (laboratoret). Fakultetet e UE-së, si njësi kryesore, organizohen në njësi bazë. Çdo fakultet ka së paku tri njësi bazë. (**EVIDENCA 1.7**).

Departamentet e UE-së, si njësi bazë, kanë në përbërje të tyre të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada dhe tituj. (**EVIDENCA 1.23**). Njësitë kryesore dhe njësitë bazë i kanë të organizuara kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore në funksion të këtij misioni. Këto njësi kanë laboratorë të dedikuar për IT si dhe laboratorë specifike për të integruar teorinë me praktikën.

UE-ja ofron programe studimi të bazuara në kulturën historike tradicionale të UE-së dhe në nevojat e tregut të punës, nëpërmjet orientimit drejt një tregu pune ndërkombëtar në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Programet e studimit ofrojnë praktikën mësimore, e cila realizohet në sajë të bashkëpunimeve të UE-së me institucione qendrore dhe vendore kombëtare, IAL apo dhe institucionale jashtë vendit.

Institucioni ka faqen e tij zyrtare të internetit: www.uniel.edu.al

Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat dhe komisionet e institucionit. (Kreu III Standardi II.3)

Në kuadër të vendimmarries, organet drejtuese të UE-së janë organizuar në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Anëtarët e këtyre organeve janë zgjedhur ose janë emëruar. Në rast se ato zgjidhen nga asambleja e personelit akademik, procesi ka qenë transparent. Organi më i lartë drejtues akademik i UE-së është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.

Senati përbëhet nga 23 (njëzet e tre) anëtarë. Njësitë kryesore përfaqësohen në Senat me nga 4 (katër) anëtarë. Në Senatin Akademik të UE-së përfaqësohen edhe studentët, në masën 10% (dhjetë për qind). Senati kryesohet nga rektori dhe mblidhet periodikisht. Anëtarët e Senatit Akademik të UE-së zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 (katër)-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar. Senati kryen veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme të UE-së. (**EVIDENCA 1.24**).

Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Ky organ është përgjegjës për garantimin e përbushjes së misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Organe kolegiale të tjera, në nivel institucional (UE) janë: Rektorati dhe Këshilli i Etikës

Rektorati UE-së është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga: rektori, zëvendësrektorët, administratori i institucionit, drejtuesit e njësive kryesore (Dekanët). Rektorati mblidhet në mënyrë periodike. Funksionet e Rektoratit janë përcaktuar në Statutin e UE-së dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit janë përcaktuar në rregulloren e UE-së.

Këshilli i Etikës i UE-së, është organ kolegjal vendimarrës, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, cenimin e integrititetit dhe interesave institucionale, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës shqyrton dhe merr vendim në lidhje me veprimtari të personelit akademik dhe atij ndihmësakademik nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Këshilli kryesohet nga zëvendësrektori. 5 (pesë) anëtarë janë përfaqësues nga secila njësi kryesore, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë të thjeshtë votash. Njëri prej anëtarëve është personel akademik me formim jurist i cili propozohet nga rektori dhe miratohet nga Senati Akademik. Këshilli i Etikës e kryen veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme të UE-së. (**EVIDENCA 1.25**).

Organ kolegjal në nivel njësie kryesore:

Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga: dekani, zëvendësdekani/ët, drejtuesit e njësive bazë. Dekanati mblidhet në mënyrë periodike. Dekanati kryen veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme të UE-së. (**EVIDENCA 1.26**).

Partneriteti

Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (Kreu III Standardi III.1)

Institucioni përfshihet në aktivitete shkencore, social-ekonomike, si konferanca dhe simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat krijojnë mundësinë për t'u njojur në mënyrë të vazhdueshme me zhvillimin rajonal ekonomik, shoqëror dhe arsimor dhe për të reflektoar në lidhje me përshtatjen e kurrikulave me realitetin e tregut të punës.

Institucioni ka praktika të monitorimit të punësimit të të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një database në nivel institucional, për të parë se sa përputhet formimi që ata marrin në këtë institucion me kërkzesat e tregut të punës. Ky monitorim realizohet nga Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, që është strukturë e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, në nivel institucioni. (**EVIDENCA 1.1**). UE mbledh informacione rreth problemeve që hasin të diplomuarit për gjetjen e punësimit të përshtatshëm në vend, në mënyrë që të përmirësojë kurrikulat dhe të ofrojë programe studimi sipas kërkzesave të tregut. Në vijimësi punohet që të kemi informacione dhe database më të plotë për këtë proces si pjesë sistematike e veprimtarisë së UE-së.

UE respekton rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në treg, duke e bazuar marketingun



Handwritten signatures of three individuals in blue ink, located at the bottom right of the page. The signatures are: 1. A long, flowing signature starting with 'Ez' and ending with 'Pec'. 2. A shorter, more compact signature starting with 'C/S'. 3. A signature starting with 'Tay' and ending with 'A/P'. Above the 'Tay' signature is a small superscript '9'.

e tij në priorititetet dhe veçoritë që kanë programet bashkëkohore të studimit që ofron, në përputhjen e programeve të ofruara me kërkesat e tregut të punës dhe në stafin e përgatitur dhe të kualifikuar, si një nga anët më të forta të tij. Në propozimet e bëra për hapjen e programeve të reja të studimit, nga UE janë bërë studime të tregut të punës, ku është studiuar nevoja e tregut të punës për specialistë të fushave të ndryshme. (**EVIDENCA 1.27**).

Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. (Kreu III Standardi III.2)

Institucioni ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e tij të zhvillimit institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. Këto prioritete reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me institucionet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nëpërmjet ngritjes së strukturave të posaçme në Rektoratin e UE, ndiqet administrimi i politikave të ndërkombëtarizimit të institucionit. Institucioni ka zhvilluar partneritet me institucionet e arsimtë lartë, brenda dhe jashtë vendit. (**EVIDENCA 1.28**). Këto partneritete kanë sjellë si produkte organizmin e aktiviteteve të përbashkëta të rëndësishme si konferenca kombëtare e ndërkombëtare, aktivitete ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë së IAL-ve, organizmin e aktiviteteve promovuese të mobiliteteve Erasmus+, trajnime e kualifikime të vazduhuara për studentët etj. (**EVIDENCA 1.29**). Këto partneritete kanë rrjetëzuar bashkëpunimin në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve, në të cilat UE është pjesë. (**EVIDENCA 1.28**). Institucioni është vizituar nga delegacione të ndryshme të universiteteve partnere, njësi përfaqësuese diplomatike e studiues virtuzozë, të cilët kanë qenë iniciatorë të projekteve të reja studimore dhe projekteve të infrastrukturës. (**EVIDENCA 1.30**).

Partnerë të UE-së janë edhe institucionet publike qendrore e vendore. (**EVIDENCA 1.31**) Këto partneritete janë kryesisht të orientuara drejt ofrimit të praktikave mësimore, në të gjitha programet e studimit, për studentët e UE-së si dhe organizimit të leksioneve të hapura me tema dhe problematika aktuale, ku dhe studentët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Të gjitha këto aktivitete publikohen në faqen web të institucionit, <http://uniel.edu.al/index.php/al/veprimtari>

UE, ka përditësuar dhe ka ndërkombëtarizuar Buletinin Shkencor të UE-së, (**EVIDENCA 1.32**) duke e pasuar atë me profesorë të universiteteve partnere bashkëpunuese si dhe duke botuar për herë të parë edhe në gjuhën angleze. Në bashkëpunim me një universitet partner në Itali, UE ka themeluar një revistë elektronike, si produkt kërkimor shkencor i dy institucioneve. (**EVIDENCA 1.33**).

Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet të tjera mbështetëse. (Kreu III Standardi III.3)

UE bashkëpunon me partnerë të tjera për plotësimin e nevojave të veta në funksion të realizimit të programeve të studimeve si për shembull Ambasada e SHBA-së, nëpërmjet programeve Fulbright dhe ELF (English Language Fellows); USAID dhe Korpusi i Paqes, i cili ofron vullnetarë për procesin e mësimdhënies etj. UE ka patur mbështetje dhe bashkëpunim nga ambasadat si ajo turke, gjermane, franceze dhe italiane, për të ndihmuar procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në departamentet e gjuhëve të huaja. (**EVIDENCA 1.34**)



Four handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page. From left to right: 1) A signature that appears to be 'Rex Gashi' with a red ink mark over it. 2) A signature that appears to be 'Lia'. 3) A signature that appears to be 'Ariela'. 4) A signature that appears to be 'Claus Aul' with a small '10' written above it.

Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar. (Kreu III Standardi III.4)

UE ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve. Politika favorizuese ndiqet edhe me personelin akademik të huaj dhe studentët, të cilët vijnë në UE. Procedura e shpalljes së thirrjes, aplikimit dhe përzgjedhjes është publike dhe e paanshme. Informacion i detajuar mbi thirrjet që hapen dhe guidat shpjeguese, gjenden të publikuara në faqen web të UE-së, <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/thirrje>. Këto mobilitete ofrohen nëpërmjet:

- Organizimit të mobiliteteve ERASMUS+ outgoing (nga UE drejt institucioneve partnere) në kuadër të partneriteteve me universitetet partnere, procedura dhe modalitetet e së cilës rregullohen në mënyrë të veçantë. (**EVIDENCA 1.35**). Periudha e mobilitetit të studentëve, i nënshtronhet procedurës së njohjes dhe transferimit të krediteve, gjithashtu duke u mundësuar dhënien e provimeve të mbetur pa shlyer në data të posaçme. (**EVIDENCA 1.36**).
- Organizimit të mobiliteteve ERASMUS+ incoming (nga universitetet partnere në UE), ku studentëve dhe personelit akademik u ofrohet informacion dhe asistencë e nevojshme. Studentëve u vihet në dispozicion oferta akademike, e cila publikohet dhe në faqen web të institucionit: <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/programe-ue/1351-university-of-elbasan-academic-offer-for-incoming-students>. Personelit i vihet në dispozicion lista e programeve të studimit si dhe në të dyja rastet një informacion i detajuar, në formën e një guide. <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/programe-ue/958-programe-studimi-ue>
- UE, në bashkëpunim me partnerët organizon dhe përzgjedh personelin akademik të ftuar. Propozimi vjen nga njësia bazë, e cila më pas miratohet në Rektorat. (**EVIDENCA 1.37**).
- Marrëdhënia akademike dhe finanaciare e personelit akademik të UE-së, i cili përfiton vitin sabatik është favorizuese. (**EVIDENCA 1.38**).
- Në UE, falë bashkëpunimit me institucionet partnere, janë pritur doktorantë, të cilët veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore e kanë organizuar në UE. (**EVIDENCA 1.39**).

Përfundimi dhe Vlerësimi

UE e ka të garantuar me ligj autonominë e funksionimit dhe lirinë akademike si Institucion i Arsimit të Lartë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Të drejtat dhe privilegjet që burojnë nga liria dhe autonomia akademike aplikohen në funksionet kryesore të institucionit, kryesisht në mësimdhënie dhe kërkim. Në kuadër të autonomisë dhe brenda limiteve të saj, institucioni dhe strukturat e tij përbërëse e ushtrojnë aktivitetin bazuar në statutin dhe rregulloren e UE-së, akte të cilat mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi. Strukturimi i brendshëm i institucionit, i përcaktuar në ligj dhe statut, është i tillë që të sigurojë eficiencë në vendimmarrje dhe menaxhim, duke favorizuar debatin konstruktiv që nga njësítë bazë deri në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.

Veprimtaria e UE orientohet nga një strategji zhvillimi 2016-2020, e cila përkon me misionin e institucionit, si dhe bëhet transparente për organet shtetërore (MASR) dhe për personelin akademik



11

e studentët. UE merr në konsideratë studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

UE ndjek një politikë shumë favorizuese në funksion të zgjerimit dhe të përforcimit të marrëdhënieve ndërmjet UE-së dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë në rajon dhe më gjerë. UE ka arritur të vendosë marrëdhënie të ngushta me IAL-të brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëdhënie bashkëpunimi kanë në bazë të tyre kryesisht shkëmbim idesh, stafi dhe studentësh, organizim të konferencave të përbashkëta si dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor. Integrimi dhe harmonizimi i kërkesave dhe nevojave të institucionit tonë me ato të institucioneve të tjera, stafit të huaj dhe studentëve, është vendosur në qendër të këtyre politikave favorizuese.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se në UE standarde përfshinë e organizimit dhe menaxhimit të tij përmbytjen plotësisht.

2 – FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore. (Kreu III Standardi IV.1)

UE përbëhet nga personel akademik (me orientim mësimor dhe/ose kërkimor shkencor), personel ndihmësakademik (me karakter mësimor ose me karakter administrativ) dhe personel administrativ. Organigrama e UE-së është publike, në faqen e web: <http://www.uniel.edu.al/images/organogramaue2017-2018.pdf>.

Punësimi në UE, sipas nevojave të njësisë të cilit i shërben, është me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme si për personelin akademik dhe për atë ndihmësakademik. Punësimi realizohet me anë të konkurrimit publik, sipas modalitetave të punësimit të miratuara nga Senati apo Bordi i Administrimit. (EVIDENCA 2.1).

UE rekruton me përparësi personel akademik të kualifikuar në universitete të njohura në shkallë ndërkontinentare. UE u jep prioritet këtyre kualifikimeve, duke i vlerësuar me pikëzim më të lartë. (EVIDENCA 2.2).

Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës dhe personelit administrativ. (Kreu III Standardi IV.2)

UE angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet personelit akademik dhe ndihmësakademik për realizimin sa më korrekt të procesit mësimor. Nga ana tjeter, personeli akademik asistohet nga personeli ndihmësakademik dhe administrativ për organizimin e ditëve të hapura. (EVIDENCA 2.3). Gjithashtu personeli bashkëpunon për organizimin e konferencave kombëtare apo ndërkontinentare si dhe në evenimente të tjera të rëndësishme ku UE merr pjesë. (EVIDENCA 2.4).

Personeli i UE-së organizon aktivitete të ndryshme sensibilizuese, në transmetim dhe përcim të



The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: 1. A signature that appears to be 'R. Bajri' with a small drawing of a key next to it. 2. A signature that appears to be 'C.S.' 3. A signature that appears to be 'C. A. B.' with a small '12' written above the last name.

mesazheve të rëndësishme që kanë të bejënë me humanizmin, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, ndërgjegjësimin apo mirëinformimin. (EVIDENCA 2.5).

Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij. (Kreu III Standardi IV.3)

UE ndjek një politikë të vazhduar të vlerësimit të aftësive dhe kualifikimit të personelit të tij. Për këtë arsy, UE merr pjesë në projektet e BE-së për ngritjen e kapaciteteve, ku kualifikohen dhe përmirësojnë njojuritë dhe aftësitë profesionale dhe akademike sipas fushave përkatëse, personeli akademik, ndihmësakademik dhe ai administrativ. (EVIDENCA 1.28). Personeli akademik vlerësohet për performancën në punë, tejkalimin e ngarkesës mësimore të parashikuar në fillim të vitit akademik dhe performancën në kërkimin shkencor. (EVIDENCA 2.6).

Në zbatim të politikave të ndërkontrollimit personeli akademik i UE-së është pjesë e personelit akademik të ftuar në universitetet partnere. (EVIDENCA 2.8).

Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social. (Kreu III Standardi IV.4)

Politika e zhvillimit social në UE, është e fokusuar në aktivitete dhe nisma sociale për studentët dhe për personelin, në përputhje me strategjinë kombëtare për politikën e zhvillimit social. Në UE, studentët përfitojnë bursë ekonomike si dhe përashtim nga pagesa e tarifës vjetore, në plotësim të kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. (EVIDENCA 2.9).

Në UE, në bashkëpunim me partnerët vendas e të huaj organizohen aktivitete të ndryshme, siç janë aktivitete të promovimit të librave, sensibilizimit të dhunës ndaj grave, ceremoni mirënjojje për figura të rëndësishme etj. Studentët dhe personeli i UE-së është bërë pjesë e nismës kombëtare për të mbështetur me burime njerëzore dhe ndihmë monetare, të prekurit nga tërmeti shkatërrimtar i nëntorit 2019 në Shqipëri. (EVIDENCA 2.10).

Personeli i UE-së ka integruar kërkimin shkencor me zhvillimin social, në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve, projektit T@SK. Fryt i këtij projekti ka qenë publikimi i një botimi për shërbimet sociale. (EVIDENCA 2.11). Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila mundëson trajnimin e personelit të Bashkisë, në rritjen e cilësisë për shërbimet sociale të ofruara. (EVIDENCA 2.12).

Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. (Kreu III Standardi II.2)

UE siguron menaxhim efikas të burimeve njerëzore. Në respektim të strukturës së UE-së, ruhet raporti midis personelit akademik, ndihmësakademik dhe atij administrativ. (EVIDENCA 2.13). Struktura e Rektoratit është organizuar në drejtori dhe në njësi. Secila drejtori ka minimalisht 2 sektorë. Një sektor përmban minimalisht 3 persona. Njësi organizohen si sektorët, e përbajnjë minimalisht 3 persona në të. Pranë çdo njësie kryesore, funksionojnë sekretari i dekanit dhe personeli ndihmësakademik me karakter mësimor si sekretaret mësimore apo laborantët.

Menaxhimi Financiar

Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara. (Kreu III Standardi VI.1)



The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: 1) 'Dr. Blerim Doda' in a large, flowing script; 2) 'Lora Gashi' in a smaller, more compact script; 3) 'Rexha Aulja' in a cursive script, with the number '13' written above it. The signatures are placed over a white background, likely a document page.

Buxheti i UE-së, është një dokument i detajuar në organizim dhe përmbajtje. Hartimi i buxhetit të UE-së është bazuar në projektet e paraqitura deri në momentin e hartimit të tij, në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin përkatës si dhe përditësimet në strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrin e studentëve, në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.

Nga strukturat e UE-së paraqiten dhe janë pasqyruar kërkesa për projektet afatmesme, si për procesin e veprimtarisë kryesore të këtyre njësive edhe për atë kërkimore e shkencore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë. Buxheti miratohet paraprakisht nga Senati e më pas i dërgohet për vendimmarrje përfundimtare Bordit të Administrimit. (**EVIDENCA 1.9**).

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare. (Kreu III Standardi VI.2)

Politika financiare e UE-së, sigurohet në pjesën e saj më të madhe nga granti i mësimdhënies, i MASR-së. Ky grant përllogaritet në bazë të kapaciteteve dhe planifikimit të dërguar më parë nëpërmjet projektbuxhetit. Mjet tjetër i nevojshëm për zbatimin e politikës financiare lidhet me vetëfinancimin e institucionit nga të ardhurat, shërbimet, pagesat e qirave. Mjet tjetër për zbatimin e politikave financiare është edhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare në të cilat UE është pjesë.

UE analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, nëpërmjet rishikimit periodik të buxhetit dhe rialokimit të fondeve sa herë lind nevoja.

Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe finanziar. (Kreu III Standardi VI.3)

UE si Institucion Arsimit të Lartë, i nënshtronhet auditimit finansiar, që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim. Auditimi është i brendshëm apo i jashtëm, si audit i ministrisë së linjës apo nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. (**EVIDENCA 2.15**). Rezultatet e auditimit finansiar të UE-së bëhen publike sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore në varësi të llojit të auditimit dhe subjektit auditues. Pas analizave dhe diskutimeve në strukturat përkatëse, raporti i auditimit finansiar diskutohet në organet kolegiale dhe bëhet publike.

Ky është një proces periodik, i cili realizohet në UE, në ndjekje të politikës së kontrollit buxhetor dhe finanziar. (**EVIDENCA 2.16**).

Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit

Institucioni disponon një sistem të informimit. (Kreu III Standardi VII.1)

UE disponon një sistem të informimit të mirëorganizuar. Ky sistem përbëhet nga një sistem i dhënies së informacionit/kthim përgjigje në mënyrë elektronike si dhe dhënien e informacionit nga strukturat ndihmësakademike në Rektoratin e UE-së si dhe pranë njësive kryesore. Informacioni mbi vendimmarrjen, njoftimet, thirrjet publike, i nënshtronhet ligjt për të drejtën e informimit, ligjt për ruajtjen e të dhënavë private <http://uniel.edu.al/index.php/al/njoftime>. Gjithashtu një pjesë e procedurave dhe njoftimet publikohen në buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.



UE publikon aktet e brendshme të saj, <http://uniel.edu.al/index.php/al/statuti-dhe-rregullorja>, të dhënat mbi programet e studimit dhe ofertën akademike. Gjithashtu UE publikon të dhënat mbi vendimmarrjen e Senatit dhe Bordit të Administrimit, Buxhetin, Marrëveshjet e Bashkëpunimit, në portalin e dedikuar <https://u-transparencia.al/>.

UE ka vënë në dispozicion një adresë elektronike, për këdo të interesuar për të marrë informacion: info@uniel.edu.al. Ndërkojë studentët, për problematika dhe informacion mbi përditshmërinë e veprimtarisë së tyre në lidhje me sistemin Education Management System EMS, komunikojnë drejtpërdrejt me specialistët e IT-së, në postën e tyre elektronike.

Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit. (Kreu III Standardi VII.2)

UE bashkërendon veprimtarinë në auditore me veprimtarinë në fushën e teknologjisë së informacionit. Sistemi EMS është funksional. Studentët kanë një llogari të tyre elektronike, në të cilën informohen mbi rezultatet akademike, ku gjenerohen procesverbalet e notave. **(EVIDENCA 2.17)** Në portalin e EMS www.uniel.ems.al, gjenden të gjitha të dhënat që i nevojiten, përfshirë orarin mësimor, vlerësimet në provime, tarifat e shkollimit, detyrimet etj.

Çdo njësi kryesore e UE-së ka në përdorim një laborator funksional të IT, për t'i përgjigjur nevojave të studentëve për TIK-un në programin mësimor.

Studentët e UE-së kanë mundësi të përdorin bibliotekën online, duke aksesuar me postën e tyre elektronike. Portali i bibliotekës online, gjendet në faqen web të UE-së: <http://uniel.edu.al/index.php/al/biblioteka-online>.

Në kuadër të mësimit në distancë, në UE, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë qendrën e “TELENURSING”. Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në Departamentin e Punës Sociale, funksionon Laboratori T@SK, i cili u ofron studentëve dhe personelit akademik të zhvillojnë procesin mësimor online nëpërmjet platformës moodle: <http://uniel.edu.al/index.php/al/platforma-moodle>

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, falë grantit konkurruesh të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI-së, ka ngritur Laboratorin Digital të Anatomisë, një laborator i cili u ofron mundësinë studentëve të studiojnë në mënyrë elektronike lëndën e anatomisë. **(EVIDENCA 2.19)**

Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme. (Kreu III Standardi VII.3)

UE ka një evidencë të saktë e të plotë për listën e pasurive të paluajtshme që disponon. **(EVIDENCA 2.20)**. UE mbikëqyr projektet e tij të ndërtimit dhe rikonstruksionit, nëpërmjet personelit të specializuar (me profesion inxhinier) në strukturat e tij si dhe kontrakton specialistë të jashtëm të licensuar si supervizor dhe kolaudator, sipas kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.8402, datë 10.9.1998 i ndryshuar.

Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. (Kreu III Standardi VII.4)

Institucioni ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. Buletini i UE-së publikohet periodikisht, që prej vitit 1999. Në UE organizohen konferenca në nderim të figurave të rëndësishme shkencore albanologjike. **(EVIDENCA 2.21)**.



15

Biblioteka e UE-së është pasuruar me një fond të posaçëm të albanologjisë dhe balkanologjisë së albanologut Christian Gut.

UE kremton përvjetorët jubilarë të lidhur me çeljen e shkollës Normale. (**EVIDENCA 2.23**).

Produktet kërkimore shkencore të UE-së, përbledhje e akteve të konferencave, libra akademikë, i dërgohen edhe Bibliotekës Kombëtare dhe Bibliotekës së qytetit. (**EVIDENCA 2.24**). UE, bën një klasifikim dhe arkivim të dokumentacionit me vlerë historike, kulturore dhe akademike të institucionit, sipas grafikut të dorëzimit dhe arkivimit.

Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij. (Kreu III Standardi VII.5)

UE ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij, me sala leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, zyra informacioni për studentët, sekretari, zyra për pedagogët, mjedise sportive, mjedise shërbimi për të tretë etj. në secilin nga fakultetet e tij.

UE disponon mjedise në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik, në përpjesëtim me numrin e tij, duke i krijuar kushte që secili nga stafi të ketë postin e tij të punës në një zyrë dhe mjedise të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin mësimor (salla për leksione, seminare, laboratorë etj.). (**EVIDENCA 2.20**).

Institucioni ngrë një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët (Kreu III Standardi VII.6)

Institucioni ofron shërbime në përputhje me nevojat e tregut rajonal. Në Laboratorin Shkencor në mjediset e ish-Kombinatit Metalurgjik ofrohen analiza të ndryshme për subjektet jashtë UE-së. (**EVIDENCA 2.27**).

Struktura logjistike administrative e UE-së është organizuar në mënyrë të tillë që t'i shërbejë interesit të përbashkët. UE ofron mjedise për zhvillimin e procesit mësimor, auditore dhe laboratorë si dhe mjedise të pushimit të studentëve, të gjelbëruara dhe me vend qëndrimi. Pranë çdo njësie kryesore ndodhet një bibliotekë e fakultetit. UE ka bibliotekën e tij qendrore, me mjedise të dedikuara për studim nga studentët dhe personeli akademik. Pranë bibliotekës së UE-së ka logistikë të posaçme për organizmin e konferencave, takimeve si dhe një qendër dedikuar të mësuarit gjatë gjithë jetës.

UE, ka ofruar mjediset e tij në shërbim të të tretëve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për veprimtaritë e librarisë/kancelarisë, bar kafe. (**EVIDENCA 2.28**).

Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit

Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. (Kreu III Standardi V.1)

UE vë në dispozicion për mësimdhënie 9 objekte të ndërtuara ose të rikonstruktua me materiale cilësore bashkëkohore. Të gjitha godinat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin e UE-së, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë, prej të cilave 7 janë për fakultete dhe një laborator (me dy godina) në ambientet e ish-Kombinatit Metalurgjik. (**EVIDENCA 2.20**).

UE është larg zonave të zhvillimit industrial apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas



standardeve përkatëse. Godinat e UE-së janë projektuar dhe ndërtuar që në ambientet / mjediset e mësimdhënies të sigurohet akustika. Mjediset e mësimit, janë izoluar nga zhurmat, luhatjet e temperatures dhe lagështirës. Të gjitha godinat e UE-së kanë sistem ngrohjeje qendore me kaldajë në çdo fakultet.

UE në normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme për Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Shkencave Humane, ofron një normativë të pritshme prej $2\text{m}^2/\text{student}$. Për Fakultetin e Shkencave të Natyrës Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, institucioni ofron një normativë të prishme prej $3\text{m}^2/\text{student}$. (**EVIDENCA 2.13**).

Edhe pse UE nuk plotëson kriteret minimale infrastrukturore të përcaktuara në VKM nr. 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, është bërë kërkesa për financim nga Qeveria Shqiptare, për rikonstrukcionin e ish- Maternitetit, një godinë 1-4 kate, me sipërfaqe prej 1313m^2 , e cila do të jetë Fakulteti i Shkencave Humane. (**EVIDENCA 2.26**).

Lartësia e mjediseve të UE-së është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). Normativa minimale e mësipërme pranonet për programe studimi të tilla si gjuhë, letërsi, sociologji, histori, gjeografi, shkencat ekonomike, juridik, matematikë, arkeologji, etj. Për programe studimi në fushën e inxhinierisë apo të shkencave të natyrës (fizikë, kimi, biologji etj.) normativat e mësipërme minimalisht dyfishohen (minimum dhe maksimumi).

Godinat e UE-së plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (23% –27 %) të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi në shumicën e rasteve është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht nga juglindja.

Godinat e UE-së, i plotësojnë kriteret e disponimit të daljeve të emergjencës në 2 apo 3 prej godinave të tij. Për godinat të cilat nuk janë pajisur me daljet e emergjencës, është percatitur projekti përkatës, por ende nuk janë realizuar. (**EVIDENCA 5.16**). Godinat e UE-së, kanë sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

Godinat e UE-së kanë burime alternative për furnizimin me energji elektrike (sistemi unazor i rrjetit shpërdarës së qytetit si dhe gjenerator etj.) si dhe rezerva të mjaftueshme të ujit (depozita uji).

Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike. (Kreu III Standardi V.2)

UE disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër dhe në formë elektronike. Dokumentacioni ruhet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në Sektorin e Protokoll Arkivës. Ky sektor merret me regjistrimin, administrimin, përpunimin e dokumentacionit hyrës dhe atë që prodhohet nga UE. Edhe struktura të tjera në njësitë e UE-së administrojnë ruajnë dhe prohijnë dokumentacion. Rregullat bazë për punën me dokumentet në institucion, zbatimi i të cilave është i detyrueshëm për të gjithë personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UE-së, përcaktohen në rregulloren e për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. (**EVIDENCA 2.7**).

Në lidhje me digitalizimin e dokumentacionit, e gjithë vendimmarrja e organeve kolegiale të



17

UE-së, është e digjitalizuar dhe publikohet në faqen web të institucionit si dhe në portalin u_transparenca/ <https://u-transparenca.al/>.

UE ka një strukturë për mbledhjen e statistikave, e cila është pjesë e Drejtorisë së Standardeve dhe Kurrikulave dhe në bashkëpunim me sekretaritë mësimore mbledh statistikat për institucionin dhe bën raportimet përkatëse në MASR.

UE disponon bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikulimit etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të depozituara pranë sekretarive mësimore të fakulteteve. UE disponon të dhëna për të gjitha programet e studimit, formën, planet e tyre mësimore, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve, të depozituara pranë njësive bazë dhe në Drejtorinë e Standardeve dhe Kurrikulave.

UE disponon një regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, i cili ruhet në sekretaritë mësimore të fakulteteve përkatëse. Ky regjistër është në formë të shkruar dhe elektronike.

UE disponon një regjistër bazë të studentëve për çdo program studimi (në formë të shkruar dhe elektronike që mbahet në ruajtje të përhershme), me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit. Të dhëna për diplomën shpërndahen vetëm në formën e shkruar. Suplementi i diplomës është në dy gjuhë dhe në formë elektronike, por nuk gjenerohet nga sistemi.

Përfundimet dhe Vlerësimi

UE punëson dhe rekruton burimet njerëzore sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të tij. Institucioni angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet personelit akademik dhe joakademik për realizimin sa më korrekt të procesit mësimor. UE vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore me nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti. Institucioni inkurajon trajnimin dhe promovimin e personelit akademik në universitetet perëndimore, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme. Në UE favorizohet dialogu social nëpërmjet ngritisës dhe diskutimit të problematikave në strukturat përkatëse. Institucioni zbaton rregulla të qarta për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve përkatëse të përcaktuara në rregulloren e UE-së.

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në UE, si institucion publik i Arsimit të Lartë, bëhet në përputhje me rregullat dhe standaret e programimit buxhetor dhe menaxhimin financier publik. Institucioni ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. UE ofron një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij, me salsa leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, zyra informacioni për studentët, sekretari, zyra për pedagogët, mjedise sportive, mjedise shërbimi për të tretë etj. në secilin nga fakultetet e tij. Ende punohet për plotësimin e kapaciteteve infrastrukturore.

UE vë në dispozicion për mësimdhënie objekte me materiale cilësore bashkëkohore dhe që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. UE ka një strukturë që përgjigjet për ruajtjen e dokumentacionit në letër. UE disponon një regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, i cili ruhet në sekretaritë mësimore të fakulteteve

përkatëse. Ky regjistër është në formë të shkruar dhe elektronike.

Standardet të cilat nuk përbushen plotësisht janë: normativa e pritshme minimale kërkohet $2.5 \text{ m}^2/\text{student}$, ndërkohë që është mesatarisht $2\text{m}^2/\text{student}$ për Fakultetin e Shkencave Humane, të Edukimit dhe Fakultetin Ekonomik, ndërkohë që ofrohet një normativë e pritshme prej $3\text{m}^2/\text{student}$ për Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, ndërkohë që normativa e pritshme minimale është $5\text{m}^2/\text{student}$. Gjithsesi, theksojmë se mos-plotësimet e këtyre standardeve nuk paraqesin ndonjë rrezik për menaxhimin e fushës së burimeve dhe institucioni është angazhuar në përbushjen e tyre sa më shpejt.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se standartet përfshinë e burimeve përbushen kryesisht.

3 – FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

Programet e Studimeve të ofruara

Institucioni ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij. (Kreu I Standard I.1)

Në UE rezultojnë 98 programe studimi prej të cilave 38 janë Bachelor, 16 programe studimi Master i shkencave, 34 programe studimi Master profesional, 8 programe me karakter profesional, 2 programe studimi në Doktoraturë në albanalogji me dy profile në gjuhësi dhe histori.

Lista e programeve të studimit të UE, është e publikuar në faqen zyrtare uniel.edu.al, si dhe u shpërndahanë në formën e fletëpalosjeve, kryesisht maturantëve, gjatë ditëve të hapura. **(EVIDENCA 3.1).** Programet e studimit janë në përputhje me misionin e UE-së për të formuar specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. Programet e studimit të UE-së janë programe studimi që lidhen me traditën dhe kulturën e institucionit, por të pasuruara me programe studimi bashkëkohore, të cilat u përgjigjen nevojave dhe dinamikave të tregut të punës. Programet e studimit ofrohen me kohë të plotë. Programet e studimeve organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

Programet e studimeve të ofruara nga institucioni janë të organizuara në mënyrë të tillë që të harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre, duke u kujdesur për të ndjekur Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institacioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen bashkimin e institacioneve të arsimit të lartë.”, në VKM 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.

Ato sipas rastit i nënshtrohen rishikimit, në përputhje edhe me kërkuesat e tregut të punës, duke i bërë kurrikulat sa më funksionale dhe të harmonizuara në këta përbërës.

UE, me vendimin e Senatit Nr 03 datë 28.01.2020, ka miratuar Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (Rregullorja e studimeve). (**EVIDENCA 3.2**). Rregullorja e studimeve ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave, detyrave, përgjegjësive lidhur me realizimin e studimeve në UE si dhe i shtrin efektet e saj mbi personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ si dhe studentët e UE-së. Të gjitha njësitë e UE-së, kanë harmonizuar rregulloret e tyre si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. (**EVIDENCA 1.26**). Rregulloret e brendshme i shtrijnë efektet në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, joakademik dhe studentët, si dhe çdo personi fizik apo juridik që vepron në objektet dhe territorin përkatës.

Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve. (*Kreu I Standardi I.2*)

Në UE është ngritur dhe funksionon LLL Center, në kuadër të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Qendra është krijuar në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET, zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem trajnimi dhe edukimi gjithëpërfshirës në Shqipëri (<https://teavet.org/>), si një qendër për trajnimin e mësuesve të arsimit bazë dhe atij parauniversitar. Qendra ofron infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për realizimin e moduleve (<http://uniel.edu.al/index.php/al/lll-modulet-e-trajnimit>) të trajnimit të certifikuar për mësuesit.

UE, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, në bashkëpunim me MASR dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), ka akredituar dhe ofron 19 module trajnimi të certifikuar për mësuesit. (**EVIDENCA 3.3**). Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike organizon konferenca ndërkombëtare, të akredituara. (**EVIDENCA 3.4**). Pjesëmarrja në këto aktivitete është gjithnjë e lartë, duke shërbyer edhe si një tregues i domosdoshmërisë për formimin e vazhdueshëm të specialistëve.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. (*Kreu I Standardi I.3*)

Oferta akademike e programeve të studimit është në përputhje me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillim të UE-së (**EVIDENCA 1.22**).

Kërkesat për aftësimin e studentëve përshkuhen në objektivat e strategjisë për zhvillim të UE-së. Universiteti është kujdesur që në mënyrë koherente të japë informacion për diplomat që lëshohen në përfundim të programit të studimeve.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë. (*Kreu I Standardi I.4*)

Politika e zhvillimit të UE-së, është bazuar në politikat kombëtare (shumëdisiplinare, promovimin e pritisë së kulturave të huaja dhe të mësuarit e gjuhëve të huaja etj.). Në të gjitha programet e studimit, minimalisht përfshihen njohuri për një deri në dy gjuhë të huaja (në këtë rast njëra si lëndë me zgjedhje) dhe në programet e studimit në gjuhë të huaja edhe tri gjuhë (njëra me zgjedhje), të cilat shtrihen në dy vitet e para të ciklit të parë të studimeve.

Në UE, studentët pajisen me njohuri që përfshijnë më tepër se sa një disiplinë, si p.sh. histori dhe gjeografi, matematikë dhe fizikë, biologji dhe kimi, ekonomia dhe e drejta, financë dhe

kontabilitet etj. (**EVIDENCA 3.5**).

UE nuk ofron diploma të përbashkëta me institucionet e tjera të arsimit të lartë, kombëtare dhe ndërkombëtare. Por universiteti, në strategjinë e vet të zhvillimit, ka marrëveshje dypalëshe me universitete ndërkombëtare dhe në planet e afërtë do të realizojë të paktën një diplomë të përbashkët në fushat strategjike dhe prioritare të studimeve dhe kërkimeve. (**EVIDENCA 3.6**).

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit. (Kreu I Standardi I.5)

Programet e studimeve organizohen në mënyrë të tillë që t'i sigurohet personelit akademik një harmonizim efektiv ndërmjet ngarkesës në mësimdhënie, punës kërkimore shkencore, angazhimeve administrative etj. (**EVIDENCA 3.7**).

Veprimtaria e personelit akademik organizohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë si dhe me aktet nënligjore në fuqi, si Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, i ndryshuar, që përcakton në përqindje raportin mes ngarkesës mësimore të pedagogut, kohës për kërkim shkencor dhe veprimtarisë në mbështetje administrative.

Për grupet mësimore respektohen kapacitetet infrastrukturore për pjesëmarrjen e studentëve në sallat e leksioneve, seminareve si dhe mjediset e posaçme për punët e laboratorit. UE ka investuar me të ardhurat e tij, krijimin dhe funksionimin e laboratoreve në njësitë përbërëse të tij. (**EVIDENCA 3.8**).

UE ka financuar me të ardhurat e tij, me propozim të njësive bazë, hapjen e programeve të reja të studimit. Në periudhën kohore maj 2016-mars 2020 në UE janë hapur 11 programe studimi. (**EVIDENCA 3.9**).

Programet e studimeve janë lehtësish të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë. (Kreu I Standardi I.6)

Përbajtja e programeve të studimeve, kurrikula, syllabuset etj. janë në dispozicion të studentëve dhe sigurohen lehtësish prej tyre. Në ditët e para të fillimit të vitit akademik, të gjithë studentët, në orientim nga personeli akademik i tyre, njihen me programet e lëndëve, kurrikulën si dhe syllabuset.

Përbajtja e programeve të studimit, në formatin e planit mësimor, me të gjitha të dhënat sasiore të programit të studimit, afishohet në mjediset e UE-së çdo fillim viti akademik.

Objektivat e programeve të studimeve janë të përcaktuara qartë, që në momentin kur aplikohet në MASR për hapjen e këtyre programeve të studimeve, bazuar kjo në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”; në VKM 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në modalitetet e propozimit për hapjen e një programi studimi janë të përcaktuara kërkasat për shprehjen e qartë të këtyre objektivave. (**EVIDENCA 3.10**).

Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara qartë nga UE. Kryesisht për programet e cikleve të dyta dhe të treta janë vendosur kritere si nota mesatare, lloji i programit të studimit në ciklin e parë Bachelor si prioritet apo i vlefshëm si kriter pranimi etj. Secili fakultet bazohet në kriteret e përcaktuara në pranimin e studentëve për programet e veta të studimit. Këto kritere, që bëhen të qarta që te modalitetet për hapjen e një programi të ri studimi, afishohen çdo periudhë që fillon aplikimi për këto programe studimi, qoftë në mjesdit e fakulteteve, qoftë edhe në faqen e web-it, te rubrika "Njoftime" e çdo fakulteti (<http://uniel.edu.al/index.php/al/njoftime-shkencat-humaner?start=10>). Për kriteret e ciklit të parë të studimeve, respektohet LAL dhe Udhëzimet e MASR-së.

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njojuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. (Kreu I Standardi I.7)

Programet e studimeve sigurojnë përfundimin me sukses të ciklit të parë bachelor dhe pranimin në ciklin e dytë në të gjitha programet e studimit, përvèç programeve dyvjeçare. Të gjitha programet e studimeve të ciklit të parë në UE, pajisin studentët me njojuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive të veçanta. Për këtë, programet e studimit në "Bachelor" përbajnë njojuritë bazë të matematikës dhe shkencave natyrore, shkencat shoqërore, por edhe për formimin e shprehive të veçanta, si: shkrimi akademik dhe krijues apo gjuhë e huaj. (EVIDENCA 3.2).

Të gjitha programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që studentët që përfundojnë ciklin e parë të kenë mundësi për punësim. Në objektivat e çdo programi studimi janë të përcaktuara aftësitë e mësuara që e lejojnë studentin të punojë.

Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambjentimi i studentit me mjesdin universitar. (Kreu I Standardi I.8)

UE ofron programe studimi të ciklit të parë, të hartuara në mënyrë të tillë, që të lehtësohet ambjentimi i studentit në mjesdin universitar. Studentët kanë mundësi të zgjedhin mes disa lëndëve me zgjedhje, duke patur liri vendimmarjeje drejt atyre lëndëve të cilët ata mendojnë se janë të nevojshme për formimin e tyre. Gjithashtu, studentëve të ciklit të parë, u ofrohet një gamë e gjerë e mundësive të zgjedhjes së gjuhës së huaj për të studiuar. (EVIDENCA 3.11). Në këtë cikël studimi, studentët kanë mundësi të kenë formim të posaçëm në teknologjinë e informacionit. Veprimitaria mësimore bashkërendohet edhe me orë të dedikuara të aktivitetit fizik, ku studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të organizuara sportive, si kampionate, konkurse etj. (EVIDENCA 3.12).

Studentët e ciklit të parë të studimit, janë përfituesit më të mëdhenj të mobiliteteve ERASMUS+, duke u mundësuar zhvillimin e një semestri akademik në njërin nga institucionet partnere. Studentët e ciklit të parë, marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga UE, për trajnime dhe kualifikime të ndryshme. (EVIDENCA 3.13).

Strukturat institucionale në UE, si Komisioni i Përherëshëm Institucional për Mbrojtjen e Studentëve, si dhe komisionet në nivel fakulteti, qëndrojnë më afér studentëve, në rast të shfaqjes së vështirësive apo problematikave që kanë lidhje me aktivitetin e përditshëm studentor.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UE përbën rreth 68% të personelit akademik

të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë. (EVIDENCA 3.14).

Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike. (Kreu I Standardi I.9)

Në përputhje me misionin e arsimit të lartë, në UE, programet e studimit të ciklit të dytë, mbështeten mbi kërkimin. Studentët e ciklit të dytë kanë një orientim të mirëfilltë kërkimor shkencor, ndërsa studentët e masterit profesional, kanë një orientim drejt kërkimit praktik. Programet e studimeve hartohen nga departamentet dhe janë rezultat i propozimeve dhe diskutimeve të të gjithë anëtarëve të departamentit. (EVIDENCA 3.10).

Praktika profesionale zhvillohen si pjesë e planeve mësimore, në bashkëpunim me sektorin privat dhe kompanitë shtetërore, duke e përmbyllur praktikën me vlerësim. (EVIDENCA 3.15).

Studentët përgatisin temat e tyre të diplomës, nën tutorimin e pedagogëve udhëheqës si dhe udhëzimeve përkatëse, në formën e një manuali për punimin e diplomës. (EVIDENCA 3.16). Ky dokument realizon mbështetjen dhe organizimin e efektshëm të procedurave të përgatitjes, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës.

Institucioni në mësimdhënie në programet e studimeve master, ka angazhuar personel akademik të ftuar, të cilët janë studiues dhe personalitete vendas apo të huaj. (EVIDENCA 3.17).

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UE përbën rreth 61% të personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe 39% personel akademik angazhuar me kohë të pjesshme, për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. (EVIDENCA 3.18).

Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjërë. (Kreu I Standardi I.10)

Programet e studimit të UE, nëpërmjet formatit të programit lëndor jep informacion të mjaftueshëm edhe për një vëzhgues të huaj: prezantimi i përbajtjes së tij është i detajuar (në të gjitha të dhënat sasiore të tij: orët mësimore, orët e studimit individual, kreditet, format e vlerësimit etj.). Programi i studimit është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite evropiane sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), por nuk është i disponueshëm për të gjithë edhe në gjuhën angleze. Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës, e cila është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze për pothuajse të gjitha programet e studimit. (EVIDENCA 3.20).

Programet e studimit në UE, ofrojnë mundësinë e përvetësimit të një kurrikule të përditësuar, e dëshmuan edhe nga numri i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me universitetet partnerë në kuadër të projekteve Erasmus+ për mobilitetet afatshkurtra. (EVIDENCA 3.19). Studentët jo vetëm janë përfitues të mobilitetit, por gjithashtu procesi i njohjes së këtyre periudhave të mobilitetit, është një proces i cili realizohet në masën 100% në çdo program studimi me një nivel të njohjes së krediteve në masën 75%. (EVIDENCA 1.36). Studentët mund të janë përfitues të mobilitetit, vetëm një herë gjatë një cikli studimesh. Periudha e mobilitetit, në varësi të marrëveshjes së bashkëpunimit zgjat nga një semestër deri në një vit akademik. Institucioni ruan një databazë të dhënash për mobilitetet e realizuara. (EVIDENCA

23

3.21). Krahas studentëve të UE, të cilët realizojnë mobilitetë në universitetet partnerë, në UE ka dhe studentë të univeristeteve partnerë, të cilët realizojnë periudhat e mobilitetit të tyre, pranë programeve të studimeve të UE. (**EVIDENCA 3.21**) UE, në rregulloren e studimeve, ka përcaktuar mundësinë e organizimit të sezoneve të posaçme për realizimin e provimeve.

Universiteti ofron mundësi për transferim të krediteve të fituara brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet ekuivalentimit të pjesëve ose programeve të plota të studimeve nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm në një institucion partner.

Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njojurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. (Kreu I Standardi I.11)

Programet e studimit organizohen sipas përbërësve të ndryshëm, ku zbatimi në praktikë i njojurive është një përbërës i rëndësishëm. Orët në auditor organizohen në të gjitha programet në leksione e seminare (ushtrime praktike), në orë laboratori, por shumë pedagogë përdorin metoda interaktive dhe nuk përdorin ndarjen tradicionale: leksion/seminar. (**EVIDENCA 3.23**).

Zbatimi i njojurive teorike bëhet edhe përmes projekteve të kursit, detyrave të lëndëve, të parashikuara në syllabuset e miratuarë për çdo program studimi. Në fund të ciklit të parë të studimeve, studentët me mesatare më të mirë, kryesisht me mesatare, sipas parashikimeve në rregulloren e studimeve të fakulteteve përkatëse.

Institucioni mbështet nga ana organizative dhe financiare, realizimin e praktikave mësimore, disa ditore, jashtë universitetit (praktikat në terren). Praktikat në terren janë pjesë e disa programe studimi kryesisht të shkencave humane dhe atyre natyrore. (**EVIDENCA 5.3**).

Gjithashtu, për programet e studimit të karaktereve të veçanta, siç është edukimi fizik, institucioni mundëson pjesëmarrjen e tyre në kampionate brenda dhe jashtë vendit. (**EVIDENCA 3.12**)

Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim. (Kreu I Standardi I.12)

Lista e programeve të studimit të ofruara nga UE, është pasuruar edhe me programe studimi me karakter të mirëfilltë profesional. (**EVIDENCA 3.24**). Pajisja e planeve mësimore me orë praktike të zhvilluara në terren, i ndihmojnë studentët për të realizuar me cilësi kalimin nga auditoret universitare në mjediset e punës. Falë bashkëpunimeve që UE implementon, studentët mirëpriten në këto institucione dhe kanë mundësi të ndjekin nga afët praktikat më të mira të punës si dhe të zbatojnë në praktikë dijet e fituara. (**EVIDENCA 1.31**).

Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Humane dhe Fakultetin e Shkencave të Edukimit, ofrohen diploma profesionale me kohëzgjatje 2-vjeçare, të cilat synojnë përgatitjen e punonjësve për tregun e punës në ndryshim të shpeshtë në Shqipëri, por edhe në botë. Këto diploma profesionale organizohen në mënyrë të tillë, që studentët të pajisen me njojuri të karakterit teorik, por mbi të gjitha praktik, të forcojnë shprehitë për profesionin e synuar.



24

Përfundimet dhe Vlerësimi

UE ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij dhe siguron që këto programe të njihen nga publiku. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UE përbën rreth 68% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve.

UE ka përcaktuar programe e studimeve prioritare që ofron dhe me të cilat ai ka vendosur të krijojë profilin e tij. Kështu, programe e studimeve që ofrohen në UE janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, e cila është e përqendruar në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm, studiuesve të rinj në fushën e albanologjisë dhe specialistëve e profesionistëve të ardhshëm në fushën e ekonomisë dhe të mjekësisë. Duke e konsideruar vizionin shumëdisiplinar prirjen e këtij shekulli në shkencë, universiteti është përpjekur t'i pajisë studentët e vet me njohuri që përfshijnë më tepër se sa një disiplinë, si p.sh. histori dhe gjeografi, matematikë dhe fizikë, biologji dhe kimi, ekonomia dhe e drejta, financë dhe kontabilitet etj. Po ashtu, këto vitet e fundit universiteti ka nxitur dhe realizuar hapjen e programeve të reja të studimit që përfshijnë studimin e një fushë shkencore dhe thellimin e njohurive në gjuhën dhe kulturën e një shteti perëndimor, si: histori dhe gjuhë gjermane, gjeografi dhe gjuhë italiane, gazetari dhe gjuhë angleze.

Përbajtja e programeve të studimit, në formatin e planit mësimor, me të gjitha të dhënat sasiore të programit të studimit, afishohet në ambientet e UE-së çdo fillim viti akademik. Në objektivat e çdo programi studimi janë të përcaktuara aftësitë e mësuara që e lejojnë studentin të punojë. Programet Master i Shkencave janë pasqyrë e projekteve kërkimore shkencore ku janë përfshirë pjesa më e madhe e stafit akademik dhe mbështesin politikat kërkimore të universitetit dhe të fakulteteve në veçanti. UE nuk ofron diploma të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare, por e ka këtë plan në të ardhmen.

Përfundimisht bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB del në përfundimin se standarde përfshijnë kurrikulave përmbytjen plotësisht.

4- FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

Organizimi i Programeve të Studimeve

Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme. (Kreu I Standardi II.1)

UE siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planit mësimor të programeve të studimeve. Një kopje e dokumentacionit dorëzohet dhe arkivohet në Drejtorinë e Standardeve dhe Kurrikulave. Në fund të çdo viti akademik, realizohet procesi i auditimit të departamenteve për të parë arritjet dhe për të vënë në dukje dhe korriguar mangësitë që rezultojnë nga ky proces. Është përcaktuar në Rregulloren e UE-së (**EVIDENCA 3.2**).

UE bashkërendon punën e personelit akademik për të siguruar koherencë të përbajtjes. Në të gjitha departamentet zhvillohen një herë në vit, në fillim të vitit mësimor, në muajin shtator,

diskutime në lidhje me leksionet dhe rinovimin e tyre me të rejat e kohës, pasurimin dhe përditësimin e literaturës dhe miratohen materialet që do të diskutohen në auditorë.

UE garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve (punë laboratori, module laboratorike, mësime praktike në objekt, praktikë profesionale e mbikëqyrur etj.), në mjediset e UE-së dhe në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, qofshin këto publike apo private. (**EVIDENCA 1.31**).

UE mbikëqyr praktikat dhe punët kërkimore (përgatitjen e projekteve, temave të diplomave, mikrotezave etj.) duke konsoliduar procedurat që lidhen me mënyrën e organizimit dhe ndjekjes së praktikave prej fillimit deri në fund të procesit. Praktikat profesionale zhvillohen në institucionë sipas profilit të përgatitjes së studentit, pranë specialistëve të fushës përkatëse dhe nën drejtimin e grupit të personelit akademik të caktuar nga departamenti. Praktikat kryhen sipas grupeve mësimore. Në përfundim të praktikës profesionale studenti përgatit një relacion për punën e kryer i nënshkruar prej mbikëqyrësit dhe titullarit të institucionit ku zhvillohet praktika. Ky relacion vlerësohet nga pedagogët që e drejtojnë praktikën. Vlerësimi bëhet me notë. Pedagogët e ndjekjes së praktikave janë vetëm pedagogë me kohë të plotë që caktohen nga departamenti përkatës, për çdo vit akademik.

UE vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme mbështetëse për programin përkatës të studimeve. Literatura gjendet në bibliotekën qendrore si dhe në bibliotekat e fakulteteve. Këto të fundit duhet të janë më të pasura me literaturë dhe më funksionale, gjë që është në priorititet e ardhshme të stafit drejtues të UE-së. Literaturë shtesë mund të sigurohet edhe në bibliotekën online <http://uniel.edu.al/index.php/al/biblioteka-online>

Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. (Kreu I Standardi II.2)

Rregullat dhe kërkesat e provimit të diplomimit janë të miratuara nga strukturat universitare përgjegjëse dhe janë të njoitura për të gjithë përmes rregullores së provimeve. UE bën të njoitura (shpall në vende të dukshme) kriteret dhe procedurat e diplomimit, sipas rregulloreve përkatëse. Ato janë të afishuara në stendat e secilit fakultet dhe të publikuara online në faqen zyrtare të internetit të UE-së. Studentëve u bëhen me dije datat e provimeve, datat e diplomimit, në ambiente publike në fakultetet përkatëse si dhe në faqen web të institucionit.

Anonimati është i respektuar gjatë korrigjimit të provimeve. Të gjitha provimet me shkrim bëhen me sekretim, procedurë që përcaktohet rast pas rasti. Pasi bëhet vlerësimi me pikë i tezës së provimit, bëhet shsekretimi në prani të komisionit, i cili i jep përgjigjen secilit prej studentëve sipas afateve të përcaktuara në rregullore (**EVIDENCA 1.26; EVIDENCA 3.2**).

Ankimimi i rezultateve të provimeve shqyrtohet nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloren e provimeve, rregulloren e fakultetit dhe programit të studimit përkatës, gjithmonë duke respektuar afatet e ankimimit të theksuara në rregullore. (**EVIDENCA 1.26; EVIDENCA 3.2**).

Studentët kanë akses në rezultatet personale të provimeve, duke respektuar parimin e konfidencialitetit. (**EVIDENCA 2.17**). Secili nga studentët ka username dhe password personal të sistemit online EMS, ku mund të verifikojnë rezultatet e provimeve, të cilat i komunikohen



26

edhe verbalisht nga komisioni në afatin e caktuar sipas rregullores.

Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë. (Kreu I Standardi II.3)

Personeli akademik vlerësohet nga struktura të institucionit që ndjekin zbatimin cilësor të programeve të studimeve. Personeli akademik vlerësohet nga strukturat drejtuese: dekanati, në mbledhjet e analizës së punës mësimore; departamenti në analizat vlerësuese përgjatë vitit akademik, nga zëvendësrektori i caktuar për vlerësimin e performancës së pedagogut. Element shumë u rëndësishëm për vlerësimin janë edhe pyetësorët institucionale dhe pyetësorët për procesin mësimor, që organizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC. (EVIDENCA 4.1).

Studentët, si fokusi kryesor i Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, kontribuojnë në mënyrë direkte me vlerësimin e tyre mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies. Ky kontribut është burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve institucionale dhe akademike që ofron UE. (EVIDENCA 4.2).

UE vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore në nivel departamenti. (EVIDENCA 4.3). Personeli akademik plotëson skedën vetjake të vlerësimit të veprimitarisë së vet shkencore, e cila dorëzohet dhe pasurohet çdo fundviti akademik. (EVIDENCA 3.7).

Çdo fundviti akademik, rishikohen programet e studimit për t'u përditësuar dhe përmirësuar në mënyrë që kurrikula të jetë sa më funksionale dhe të përshtatet më mirë me kërkesat e tregut të punës. Diskutimi zhvillohet në fillim në departamente, më tej propozimet për ndryshim i përcillen dekanatit ku sërisht ka diskutim në lidhje me propozimet e bëra dhe më tej i përcillen Senatit Akademik për diskutim dhe vendimmarrje. (EVIDENCA 3.2) Në këtë aspekt, duhet të merret në konsideratë më shumë mendimi i studentëve.

Institucioni ndjek një politikë të quartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. (Kreu I Standardi II.4)

Departamenti është një strukturë bazë e cila promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Por politika e universitetit është inkurajimi i mobilitetit të personelit akademik me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies në universitet.

UE ka ngritur mekanizma mbështetës për eksperimentimin në mësimdhënie. Pranë FSHE-së është ngritur Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim, misioni i së cilës është përmirësimi i mësimdhënies në universitet dhe promovimi i cilësisë së saj.

UE kualifikon personelin akademik në fushën e kërkimit shkencor, duke e konsideruar këtë si një prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Njëkohësisht ofron lehtësira në mënyrë që stafi të përqendrohet te kërkimi shkencor, nëpërmjet reduktimit të ngarkesës mësimore, vitit sabatik etj.

Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarries në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner. Në UE implementohen projekte për ngritjen e kapaciteteve, të cilët kanë në fokus

ngritjen e kapaciteteve humane, nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve, rritjen e kapaciteteve infrastrukturore, nëpërmjet ngritjes së laboratoreve të dedikuara për këtë qëllim si dhe shkëmbimit të vizitave studimore ndërmjet partnerëve. Informacioni mbi projektet ku UE bën pjesë, gjendet dhe i publikuar në faqen web, së bashku me link-et përkatëse të secilit projekt <http://uniel.edu.al/index.php/al/projekte>

Senati i UE-së ka përcaktuar modalitetet dhe standarde rekrutimit të personelit akademik, ndërkoq që departamentet përcaktojnë kriteret sipas specifikave që ato kanë në lidhje me këto rekrutime. (**EVIDENCA 2.1**).

UE nuk ka terrene të mjaftueshme sportive në mjediset e veta, por përmes marrëveshjeve të lidhura me institucione publike apo private, është mundësuar në vijimësi sigurimi i këtyre hapësirave të nevojshme. (**EVIDENCA 4.5**).

Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre.

Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.1)

UE ka 5 fakultete me 24 departamente e 2 qendra kërkimore. Secila prej këtyre njësive është e grupuar sipas mësimore përkatëse dhe në to veprojnë grupet mësimore-kërkimore përkatëse, të cilat kryejnë hulumtime të ndryshme studimore të fushave të ndërlidhura me programet që ato mbulojnë. (**EVIDENCA 1.7**).

Departamentet organizohen në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimore-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit. Grupet e kërkimit janë të përbërë nga anëtarë të personelit të fokusuar kryesisht në kërkime dhe publikime. Qendrat e kërkimit janë të organzuara kryesisht si grupe kërkimore për t'i dhënë një shtysë më të madhe kërkimit shkencor në UE, në përputhje me strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit (**EVIDENCA 1.22**).

Departamenti përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore. Departamentet monitorojnë grupet kërkimore rregullisht dhe koordinojnë aktivitetet kërkuese. Në periudha të ndryshme, anëtarët e departamentit ndajnë mes tyre informacionin në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore që ata zhvillojnë dhe shprehin kërkimesat që ata mund të kenë në lidhje me lehtësimin e veprimtarisë së tyre kërkimore-shkencore. Çdo departament ka përgjegjësi të hartoje një raport të përvitshëm që vlerëson ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore. Departamentet e UE-së mbështeten financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga Rektorati i UE-së. Plani i buxhetit institucional parashikon fonde për kërkimin shkencor për çdo departament.

Departamentet në UE, bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore sugjerojnë vazhdimësinë ose ndërprerjen e veprimtarisë së tyre.

Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor. (Kreu II Standardi I.2)

Institucioni mbështet grupet dhe projektet kërkimore shkencore të reja. UE mirëpret dhe inkurajon propozimet kërkimore dhe vendos mbi ecurinë e tyre gjatë gjithë vitit akademik, duke u bazuar në burimet financiare të miratuara. (**EVIDENCA 1.17**).

UE është duke bashkëpunuar me institucionet e tjera kërkimore publike dhe private sidomos në fushën e mësimdhënieve. (**EVIDENCA 1.28**)

Strukturat e ndryshme brenda UE-së ndërveprojnë me njëra-tjetrën, por edhe me institucionet të ndryshme publike apo private brenda dhe jashtë vendit për të mundësuar ofrimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënieve dhe kërkimit shkencor. (**EVIDENCA 1.31**).

Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit (Kreu II Standardi I.3)

UE organizon si dhe merr pjesë në konferanca shkencore të organizuara nga institucionet e tjera. Kjo pasqyrohet rregullisht edhe në faqen e internetit të institucionit. Secili prej fakulteteve ka organizuar disa konferanca kombëtare apo ndërkombëtare në partneritet me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në pesë vitet e fundit janë organizuar gjithsej 26 konferanca kombëtare dhe ndërkombëtare me tematika të ndryshme që lidhen me politikën zhvillimore të UE-së si dhe me tendencat e zhvillimit të tregut dhe kërkimit shkencor në vazhdimësi. (**EVIDENCA 4.6**) Të gjitha aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit <http://uniel.edu.al/index.php/al/veprimtari> si dhe në rrjetet sociale zyrtare: https://www.facebook.com/Universiteti-Aleksander-Xhuvani-Elbasan-Faqja-Zyrtare-764665406996189/?epa=SEARCH_BOX

UE zhvillon kërkime në fushën e shkencave të natyrës dhe në shkencat mjekësore dhe teknike, duke përfshirë objektet e veta laboratorike, por laboratorët nuk ofrojnë burime të mjaftueshme.

UE disponon kapacitetet për të qenë i pranishëm në mjediset akademike ndërkombëtare. Anëtarët e personelit akademik përveç veprimtarisë së mësimdhënieve i kushtojnë vëmendje angazhimeve në fushën e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në konferanca shkencore ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare apo edhe angazhime të tjera të këtij lloji. (**EVIDENCA 4.7**).

UE ka nënshkruar marrëveshje të shumta me IAL-të brenda dhe jashtë vendit. Procesi i ndërkombëtarizimit është një nga prioritetet e institucionit. Për këtë arsy, rritja e bashkëpunimit, organizimi i eveneve të përbashkëta dhe iniciativat e ndryshme për kërkimin shkencor, kanë nisur nga këto marrëveshje për t'u konkretizuar në projekte të mirëfillta të cilat implementohen sot. E tillë është dhe revista Euro-Balkan Law and Economics Review, e cila është një revistë e bashkëthemeluar dhe e bashkëdrejtuar me personel akademik e ndihmës akademik të UE-së dhe Universitetit Aldo Mori, Bari, Itali, <https://ois.cimedoc.uniba.it/index.php/law/about/displayMembership/19>, e pajisur me ISSN ISSN: 2612-6583

Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.4)

Departamentet dhe qendrat e kërkimit, përmes diskutimeve, veprimtarisë së tyre akademike dhe kërkimore orientojnë prioritetet e institucionit në fushën e kërkimit shkencor, duke patur për bazë edhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. (**EVIDENCA 1.22**). Këto prioritete janë në përputhje me qëllimet institucionale.

Pranë UE, në funksionim si njësi bazë, janë dhe dy qendra këkrimore. Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike, e cila e kryen veprimtarinë e saj pranë Fakultetit të Shkencave Humane si dhe Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin në Edukim, pranë Fakultetit të



29

Shkencave të Edukimit. Personeli akademik i këtyre njësive, është me orientim kërkimor shkencor.

UE favorizon debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura, diskutimeve të leksioneve të reja në departament, seminareve, ku personeli akademik angazhohet në diskutim të ideve dhe arritjeve shkencore.

Institucioni zbaton prioritetet kërkimore shkencore. (Kreu II Standardi I.5)

Institucioni siguron mjetet për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara prej tij. Struktura dhe organet e UE-së sigurojnë mjetet (si laboratorët, mjediset e bibliotekave etj.) për zbatimin e prioriteteve të caktuara. Mjediset, stafi, mbështetja që sigurohet nga institucioni mundësojnë zbatimin e tyre.

Institucioni rekruton personel akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. UE bën kujdes në afrimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, e shprehur kjo në rregulloren e rekrutimit të stafit akademik. (**EVIDENCA 2.1**). UE u jep prioritet aplikantëve që zotërojnë grada apo tituj akademikë, veçanërisht atyre që këto tituj i kanë marrë në universitete të huaja.

Prioritetet kërkimore të UE-së janë në përputhje me qëllimet institucionale, të cilat rrjedhin nga politikat zhvillimore të institucionit.

Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.6)

Kërkimi shkencor përbën një nga pikat kyçe të strategjisë së zhvillimit të UE-së. (**EVIDENCA 1.22**). UE bashkëpunon në mënyrë të ngushtë me institucione private dhe publike kombëtare në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit dhe kontratave. UE ka bashkëpunim të ngushtë me struktura të Akademisë së Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, me Institutin e Kërkimeve Biologjike dhe Mjedisore, universitete të tjera të RSH-së etj.

UE angazhohet për hartimin dhe zbatimin e politikave shkencore rajonale dhe kombëtare. Kështu, UE është angazhuar për të përkujtuar personalitete shkencore të rajonit dhe të trevës së Elbasanit, kjo përmes organizimit të konferencave dhe sesioneve jubilare për këto figura, gjithashtu edhe në studimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit etj. Të gjitha aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit: <http://uniel.edu.al/index.php/al/veprintari>

Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. UE ka zgjeruar dhe mirëpret çdo bashkëpunim me studiuesit e huaj. Është mundësuar prania e disa studiuesve të huaj në UE duke marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare të organizuara pranë UE-së, gjithashtu studiues të huaj kanë marrë si pjesë si personel akademik i ftuar, në programe të ndryshme studimit në universitetin tonë. (**EVIDENCA 3.17**)

UE ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik. UE inkurajon personelin akademik për të marrë pjesë në projekte kërkimore në institucione brenda dhe jashtë vendit. Pjesëtarë të personelit akademik të UE-së janë lektorë apo pjesëtarë të grupeve kërkimore në universitete jashtë vendit. Dhënia e lejeve administrative të pagueshme për pedagogë që marrin pjesë në projekte afatshkurtra, krijimi i lehtësirave për mobilitetin, akordimi i vtit sabatik për pedagogë që kryejnë kërkime shkencore afatgjata, janë praktika të mira në këtë drejtim.



30

UE, për të nxitur rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e studimeve, fton personel akademik të huaj të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura si dhe me angazhime me kohë të pjesshme.

Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.7)

UE mbështet organizimin e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore. UE ka organizuar simpoziume dhe konferenca të shumta duke krijuar në këtë mënyrë një traditë në fushën e kërkimit shkencor. UE ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Këtë e bën duke i publikuar në organin e vet "Buletini shkencor", i cili është edhe ndërkombëtarisht i verifikueshëm (**ISSN: 2221-5946**).

Institucioni ndjek një politikë të promovimit të kulturës kërkimore në nivel rajonal dhe kombëtar. Aktivitetet shkencore të UE-së kanë një ndikim pozitiv në kulturën kërkimore shqiptare.

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.8)

UE nuk ka një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Por departamentet, në grupet e veta, vlerësojnë rezultatet në fushën kërkimore të secilit pedagog.

UE ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. UE ka organizuar simpoziume dhe konferenca të shumta duke krijuar në këtë mënyrë një traditë në fushën e kërkimit shkencor. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. Mbrojtja e pronësisë intelektuale është siguruar nga dhënia e të drejtave ekskluzive për vetë studiuesit si dhe bëhen përpjekje për shkëmbimin e përvojave të mira përmes aktiviteteve promovuese, si ditët akademike, prezantime të botimeve të pedagogëve të UE etj. (**EVIDENCA 4.8**).

UE inkurajon kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor. UE nxit përfshirjen e studiuesve të rinj në projektet kërkimore. Studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare të organzuara nga UE, edhe me referime shkencore. Personeli akademik i UE, ftohet në cilësinë e ekspertit, në iniciativa të ndryshme, apo nisma ligjore të ndërmarra nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (**EVIDENCA 4.9**).

UE informohet në mënyrë periodike për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij. Personeli akademik jep informacion në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore.

Përfundimet dhe Vlerësimi

UE siguron zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimeve. Ato janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm. Në fund të çdo viti akademik rishikohen programet e studimit për t'u përditësuar dhe përmirësuar në mënyrë që kurrikula të jetë sa më funksionale dhe të përshtatet me kërkesat e tregut të punës. Përfshirja e mendimit të studentëve në këtë proces mbetet një detyrë për t'u përmirësuar në të ardhmen.

UE garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve. UE vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme mbështetëse për

programin përkatës të studimeve.

UE përpinqet që të sigurojë të gjitha kushtet infrastrukturore dhe mbështetëse në mënyrë që mësimdhënia të jetë sa më cilësore, duke u kujdesur që të përgjedhë një staf akademik kompetent, të kualifikuar dhe të motivuar për të aplikuar të rejat më të fundit të kërkimit shkencor dhe të metodologjisë së mësimdhënieve.

UE mbështet kërkimin shkencor, duke përcaktuar prioritetet e tij mbështetur në strategjinë e zhvillimit institucional. UE ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e stafit akademik. Pjesëtarë të stafit akademik të UE-së janë lektorë apo pjesëtarë të grupeve kërkimore në universitete jashtë vendit. UE inkurajon stafin akademik për të marrë pjesë në projekte kërkimore në institucionale brenda dhe jashtë vendit.

UE bashkëpunon me institucionale të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit, përmes projekteve të përbashkëta, organizimit të konferencave shkencore dhe bashkëpunimeve të tjera si pjesë e përpjekjeve për përhapjen dhe transferimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara GVB, konkludon se standartet për fushën e mësimdhënieve, mësimnxënieve, vlerësimit dhe kërkimit përbushen plotësisht.

5 – FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi

Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj. (Kreu I Standardi III.1)

Pranimi i studentëve të rinj në UE, bëhet sipas një plani të organizuar, nisur nga propozimet e secilës njësi bazë. (**EVIDENCA 5.1**).

Politika për pranimin e studentëve të rinj, që ndiqet në UE, përqendrohet në:

- Kuotat e pranimit të cilat hartohen dhe miratohen në respektim të kapaciteteve infrastrukturore dhe kapaciteteve në burime njerëzore të institucionit. (**EVIDENCA 2.13**).
- Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë preferencë, ku programet e studimit të ofruara nga UE, u bëhen me dije paraprakisht kandidatëve studentë në portalin e maturës shtetërore. Gjithashtu në portal publikohen edhe kriteret e pranimit, të përcaktuara nga secili program studimi. (**EVIDENCA 5.2**).
- UE për studentët e vitit të parë, ofron mundësi të përfitimit të pajisjes me bursë dhe përjashtim nga tarifa vjetore e studimit, bazuar mbi treguesit e studentëve ekselentë apo studentë të cilët përfitojnë sipas përkatësisë në grupe të caktuara, të përcaktuara nga VKM nr. 39 datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, VKM nr. 755, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e

- kritereve për përsitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar", VKM nr. 40 datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," të ndryshuar.
- UE organizon aktivitete të ndryshme për informimin e kandidatëve studentë, nëpërmjet organizimit të ditëve të hapura, pjesëmarrjes në panairet e studimit dhe punës. (**EVIDENCA 2.3**).
 - Gjithashtu, në universitet po shtohen praktikat e organizimit të eveneve dhe veprimtarive të ndryshme, ku ftohen edhe gjimnazistë të shkollave të ndryshme të mesme të qytetit, me qëllim njojen e tyre me programet e studimit dhe me veprimtaritë shkencore dhe kulturore që organizohen në UE. (**EVIDENCA 5.4**).

Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik. (Kreu I Standardi III.2)

UE ka krijuar struktura të dedikuara për komunikimin me studentët, për komunikimin e studentëve dhe personelit akademik. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-i është krijuar sipas përcaktimeve në Statutin e UE-së. Zyra ka realizuar procedurat e gjurmimit të studentëve, në institucionet publike të Qarkut të Elbasanit e më gjerë. (**EVIDENCA 5.5**). Ka filluar dhe vazhdon të pasurohet me informacion databaza e krijuar për këtë qëllim nga zyra. (**EVIDENCA 5.6**).

Gjithashtu është krijuar dhe funksionon në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore, Komisioni i përherëshëm institucional për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës si dhe Komisioni në nivel njësie kryesore për mbrojtjen e studentëve. Këto komisione, të cilët kanë anëtarë dhe përfaqësues të zgjedhur të studentëve, organizojnë punën e tyre nëpërmjet mbledhjeve periodike, ku diskutohen problematika dhe iniciativa që kanë lidhje drejtpërdrejt me studentët. (**EVIDENCA 5.7**).

Në UE është ngritur dhe funksionon Këshilli Studentor i UE-së, i organizuar sipas Rregullores për Organizimin e zgjedhjeve për Këshillin studentor të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xuvani". (**EVIDENCA 5.9**).

Një nga strukturat më të rëndësishme për informimin e studentëve dhe që siguron komunikimin student pedagog, është sekretaria mësimore. Pranë çdo njësie kryesore është ngritur sekretaria mësimore e cila të gjithë veprimtarinë e saj e ka të drejtuar në interesin më të lartë të studentëve.

UE, në web site të universitetit, ka zëra të dedikuara informacionit dhe njoftimit. Në këto rubrika vendosen informacionet dhe njoftimet drejtuar studentëve, për elementet e procesit mësimor, publikim të vendimmarrjeve të organeve përkatëse, orarin mësimor, njoftime dhe publikime të ndryshme. Gjithashtu, për çdo paqartësi apo problematikë, studentëve u është vënë në dispozicion një email për dhënien e informacionit: info@uniel.edu.al

UE mban dosjen personale të çdo studenti në Sekretarinë Mësimore. Kjo dosje krijohet që në

momentin e regjistrimit të studentit dhe përditësohet me të dhëna të tjera, përgjatë “jetës universitare” të tij në institucion. Në të ardhmen duhet të konsiderohet përditësimi i kësaj dosjeje edhe me elemente të tjera, si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, punimi i tezës së diplomimit etj.

Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve. (Kreu I Standardi III.3)

UE ka një strukturë të orientimit dhe këshillimit për studentët. Në UE është ngritur Qendra për Këshillimin Studentor pranë korpusit kryesor. Sekretaria mësimore luan rol të rëndësishëm në orientimin dhe dhënien e informacioneve për çështje të ndryshme.

UE angazhohet në informimin dhe orientimin e studentëve me bazë departamenti. Në programet disiplinore të miratuarë në departament janë të parashikuara oraret dhe klasat e takimit të studentëve me secilin pedagog për këshillime për lëndën etj.

Programet e studimeve në UE mundësojnë adaptimin progresiv të studentit me programin e studimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi zgjedhjeje ndërmjet disa lëndëve në programin e tyre të studimit. Politikat e hartimit të kurrikulave janë të tillë që viti i parë i studimeve të përfshijë lëndë të formimit të përgjithshëm dhe lëndë të aftësimit të shprehive për studime universitare (si shkrim akademik e krijues etj.). Ndërsa në vitet e tjera kemi përparim të njojurive, duke u thelluar në fushat specifike të studimit.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta. (Kreu I Standardi III.4)

UE ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta. Studentët që i përkasin kategorive sociale të veçanta, janë përfitues të bursave ekonomike dhe përfitues të përjashtimit nga pagesa e tarifës së shkollimit. (**EVIDENCA 2.9**) E njëjtë politikë ndiqet edhe për studentët pjesë e kategorive të marginalizuara, siç janë dhe ballkano-egiptianët, të cilët gjithashtu janë përfitues bursave ekonomike dhe përfitues të përjashtimit nga pagesa e tarifës së shkollimit. UE ofron kuota të veçanta për kategoritë e marginalizuara si dhe kuota të veçanta për studentët e huaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Njëkohësisht në UE ka edhe një program studimi “Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome” (**EVIDENCA 5.10**), i cili ka 2 vite që nuk hapet për shkak të mungesës së studentëve të interesuar për këtë program studimi. Por departamenti i gjuhësisë po harton një projekt për studimin e gjuhës dhe kulturës rome në trevën e Elbasanit, ku do tëjenë të përfshirë ish-studentë të këtij programi studimi dhe studentë romë të programeve të ndryshme studimi, që frekuentojnë programet e studimit në universitetin tonë. UE ndjek një politikë mbështetëse për studentët që angazhohen në aktivitete sportive të niveleve të larta, si skuadra futbolli, basketbolli etj., duke krijuar lehtësi në ndjekjen e procesit mësimor, duke krijuar sezone të veçanta provimi, duke bërë konsultime etj.

Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët. (Kreu I Standardi III.5)

UE ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët. UE ka një strukturë të mirorganizuar të Bibliotekës qendrore dhe bibliotekave të organizuara pranë çdo njësie kryesore. Bibliotekat ofrojnë hapësira të dedikuara për studentët për leximin si dhe një fond të pasur të librave universitarë dhe literaturë ndihmëse plotësuese. Fondi i bibliotekës pasurohet herë pas here me anë të abonimeve në revista kombëtare e ndërkontinentale ku UE është abonuar, donacione dhe dhurime të fondit të bibliotekës. (**EVIDENCA 5.12**)

UE pasuron në mënyrë të vazhdueshme literaturën e bibliotekës universitare në varësi të nevojave për literatura të ndryshme. (**EVIDENCA 5.12**) Pasurim tjetër të literaturave përbën edhe lidhja online me biblioteka të ndryshme kombëtare dhe ndërkontinentale. Biblioteka pasurohet shpesh edhe nga dhurimet e fondeve të librave për UE.

UE parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e çdo fakulteti dhe në varësi të mundësive financuese. (**EVIDENCA 1.17**)

Oraret e punës së bibliotekës në UE, gjatë të cilave punonjësit u përgjigjen nevojave të studentëve, shpalen në mjediset e institucionit.

Studentët që shfrytëzojnë bibliotekën pajisen me një kartelë regjistrimi përmes së cilës siguron literaturën. Në të ardhmen, janë planifikuar edhe kartat elektronike të bibliotekës.

- Së dyti, pranë UE funksionon mundësia e konsultimit të literaturës online. Është mundësuar ofrimi i kësaj platforme, në sajë të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me RASH (Rrjeti Arsimor Shqiptar). (**EVIDENCA 5.13**). Kjo nëpërmjet aksesit që kanë studentët e UE-së, në portalin e ofruar: <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/biblioteka-online>.
- Së treti, pranë UE organizohet dhe funksionon publikimi i një reviste shkencore periodike, BULETINI SHKENCOR I UNIVERSITETIT TË ELBASANIT. Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme përfshirë përparrimin e shkencës. Çdo botim i Buletinit Shkencor i vihet në dispozicion fondit të bibliotekës dhe është i aksesueshëm nga cilido student.

Institucioni u ofron studentëve të ciklit të parë mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre. (Kreu I Standardi III.6)

UE ofron për studentët udhëheqje dhe kujdestari (tutorat). Kjo realizohet gjatë fazës së punimit të temave të diplomës nga studentët në të gjitha ciklet e studimeve. Procedura të qarta të shpërndarjes së udhëheqjeve të temave të diplomës parashikohen nga UE në bazë të rregullores së programeve të studimit.

UE ndihmon dhe orienton studentin për mënyrën e sigurimit të literaturës. Kjo gjë realizohet nga vetë pedagogët e lëndës apo dhe nga departamenti përkatës i programit mësimor.

UE nuk ofron kurse për të ndihmuar studentët në vështirësi, por zhvillohen konsultime me pedagogët sipas nevojave që kanë studentët, të planifikuara në programet mësimore, përvicë konsultimeve të parashikuara në programet disiplinore.

Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale. (Kreu I Standardi III.7)

Studentët inkurajohen në pjesëmarrjen në jetën institucionale. Ata përfaqësohen në organe në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore. Senati Akademik i UES-së ka në përbërje 2 studentë senatorë, të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në komisionet e përhershme në nivel institucioni si dhe në komisionet e njësive kryesore. (**EVIDENCA 5.7**). Studentët marrin pjesë në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore institucionale dhe në njësi kryesore. (**EVIDENCA 1.13; EVIDENCA 5.7**) Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentorë, institucionalë dhe në njësitë kryesore. Ndër të tjera, studentët janë pjesë e hartimit të raporteve të rëndësishme institucionale, si Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional.

Senatorët studentë të Senatit Akademik në UE shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregullloret e studimeve etj. Ky mendim merret drejtpërdrejt nga takimet me studentët, nëpërmjet avokatit të studentëve ose nëpërmjet kutisë së ankesave. P.sh. një nga sugjerimet që kanë dhënë zakonisht studentët është për ndryshimin e planit kalendarik të provimeve të sezonit.

UE mbështet organizimin e studentëve dhe finançon veprimtarinë e tyre. Duhet përmendur që këto financime janë minimale bazuar në hapësirat që lejon ligji dhe mundësitet e buxhetit të institucionit.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore. (Kreu I Standardi III.8)

UE ndjek një politikë për të lehtësuar jetën studentore sipas mundësive të buxhetit të institucionit.

UE, sipas mundësive dhe fondeve që ka, mbështet studentët që angazhohen në veprimtarit sportive dhe kulturore të organizuara nga strukturat e tij dhe institacione të tjera.

UE bashkëpunon me strukturat shëndetësore për ndjekjen e politikave parandaluese dhe kuruese në ndihmë të shëndetit të studentëve. P.sh. ka veprimtari periodike me Kryqin e Kuq. Në mjediset e shërbimit në institucion, janë vendosur kuti të ndihmës së shpejtë, të cilat kanë disa elementë parësorë të ofrimit të saj. (**EVIDENCA 5.15**).

Në raste emergjente dhe rreziku, strukturat e UES-së janë të pajisura me dalje dytësore si dhe po finalizohen procedurat për pajisjen e dy strukturave me shkallë emergjence. (**EVIDENCA 5.16**). Gjithashtu në mjediset e përbashkëta janë vendosur fikset e zjarrit. Në çdo rast, mjediset e strukturave të UES-së, janë të pajisura me kamera sigurie si dhe me mbrojtje fizike. (**EVIDENCA 5.17**).

Institucioni favorizon punësimin e studentëve. (Kreu I Standardi III.9)

UE gjurmon dhe favorizon punësimin e studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI ka krijuar një databazë të gjurmimit të studentëve të diplomuar.

Favorizimi i punësimit të studentëve, mundësohet nëpërmjet organizimit të praktikave

[Handwritten signatures] 36

mësimore në institucionet partnere, të cilat kanë ofruar mundësi reale të punësimit të studentëve me performancën më të mirë. Gjithashtu, në UE, janë pjesë e personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, ish-studentë të UE-së. (**EVIDENCA 5.18**). Nëpërmjet bashkëpunimit me institucione vendase dhe të huaja, në UE implementohen disa programe trajnimi dhe punësimi me afat të caktuar. (**EVIDENCA 5.19**).

Përfundimet dhe Vlerësimi

UE ndjek një politikë korrekte për informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, përmes publikimit online të ofertës akademike dhe organizimit të Ditëve të Hapura dhe ofrimit të literaturës bazë të nevojshme, që gjendet në çdo librari. Në UE është ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila kujdeset për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Po ashtu, sistemi EMS i komunikimit është një praktikë e mirë që siguron komunikimin ndërmjet studentëve dhe personelit akademik.

UE ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara sipas ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve të MASR-së. UE ndjek një politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egiptianë. Në këtë kuadër, në UE ka një program studimi “Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome”.

Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në jetën institucionale të UE-së realizohet përmes përfshirjes së përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik dhe komisionet në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. UE ndjek politika të gjurmimit dhe favorizimit të punësimit të studentëve të saj.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se standardejt përfshirë fushën e studentëve dhe mbështetjes së tyre përmbytjen plotësisht.



Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm

Gjatë periudhës 3-vjeçare, pas akreditimit të fundit, institucioni ka marrë të gjitha masat akademike dhe administrative për përbushjen e rekomandimeve. Veprimtaria e UE-së në aspektin akademik-shkencor dhe atë administrativ, paraqitet në përbushje të standardeve të të 5 fushave të vlerësimit. Për organizimin dhe strukturimin, UE garanton vendimmarrje dhe menaxhim eficent të burimeve, në funksion të përbushjes së misionit dhe objektivave të këtij institucioni.

Po kështu, UE ndjek politika të miratuara të shpërndarjes dhe administrimit të burimeve njerëzore dhe materiale. Këto politika i nënshtronen debatit konstruktiv gjithëpërfshirës në organet drejtuese përpara vendimmarrjes. Është rritur në mënyrë të ndjeshme pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje.

Në fushën e kurrikulës, UE ofron programe studimi në të tre ciklet si dhe programe studimi profesionale 2-vjeçare. Programet e studimit ofrohen në përputhje me misionin, strategjinë për zhvillim dhe kushtet infrastrukturore të tij. Është punuar në drejtim të përshtatjes së ofertës akademike ekzistuese me tregun dhe nevojat e tij në ndryshim në Shqipëri, duke e pasqyruar në tërësinë e programeve të studimit të ofruara nga UE.

Krahas punës për zhvillimin me korrektësi dhe cilësi të mësimdhënies, personeli akademik i kushton vëmendje mjaft të madhe veprimtarisë kërkimore-shkencore (individuale dhe në grup) me qëllim kualifikimin e mëtejshëm shkencor. Kërkimi shkencor është standard që mbahet si objektiv strategjik orientues në veprimtarinë e UE-së. UE ka realizuar ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor dhe të rezultateve të kërkimit.

UE ndjek një politikë mbështetëse për studentin, duke përshirë të gjitha fazat e jetës së tij në IAL, në të gjitha ciklet e studimit, që nga regjistrimi në UE deri në punësim. Në fazat e jetës studentore, kjo politikë rezulton efikase, por po punohet ende në lidhje me gjurmimin e studentëve pas përfundimit të studimeve.

Bazuar mbi përfundimet dhe vlerësimet e secilës prej fushave të analizuara në raport, gjykimi i përbledhur sipas fushave, për përbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësise, është si më poshtë:

Fusha Organizimi dhe Menaxhimi: Standardet përbushen plotësisht

Fusha Burimet: Standardet përbushen kryesisht

Fusha Kurrikulat: Standardet përbushen plotësisht

Fusha Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe kërkimi: Standardet përbushen plotësisht

Fusha Studentët dhe mbështetja e tyre: Standardet përbushen plotësisht.

Përfundimisht grupi i vetëvlerësimit gjykon se UE, në nivel institucional, standardet e cilësisë përbushen plotësisht.



38

LISTA E EVIDENCAVE

EVIDENCA 1.1	Statuti i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.2	Për emërimin në detyrë të anëtarëve të BA të UE-së dhe anëtarëve përfaqësues të MASR-së
EVIDENCA 1.3	Vendimi i SA për emërimin e anëtarëve të BA në UE
EVIDENCA 1.4	Vendim BA Nr. 1 datë 14.04.2017 Për miratimin e rregullores përfunksionimin e Bordit të Administrimit të UE-së
EVIDENCA 1.5	Vendim BA Nr. 2 datë 14.04.2017 Për caktimin e sekretarit administrativ të Bordit të Administrimit të UE-së
EVIDENCA 1.6	Vendimi Nr. 7 datë 23.06.2017 Për emërimin e administratorit të UE-së
EVIDENCA 1.7	Vendimi Nr. 7 datë 12.02.2020 Për miratimin e numrit të personelit dhe pagat për të gjitha nivelet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
EVIDENCA 1.8	Raporti vjetor i veprimtarisë të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", 2018-2019
EVIDENCA 1.9	Për miratimin e buxhetit të vitit 2020, të UE-së
EVIDENCA 1.10	Vendimi Nr 09 datë 10.04.2020 Për miratimin e rregullores Ekonomiko-Financiare të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.11	Lista e anëtarëve të Senatit Akademik, 2016-2020 të UE-së
EVIDENCA 1.12	Konstituimi i Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor të UE-së.
EVIDENCA 1.13	Vendim SA Nr 12 datë 05.07.2019 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit"
EVIDENCA 1.14	Vendime të Bordit të Administrimit për vendosjen e tarifave në UE
EVIDENCA 1.15	Detajimi per Grantin e Mësimdhënies të vitit 2020 në UE
EVIDENCA 1.16	Çelje e llogarive bankare për projektet e BE-së
EVIDENCA 1.17	Model-propozimi i një projektbuxheti nga një departament/ FSHN
EVIDENCA 1.18	Model-propozimi për një program të ri studimi (Operator i Gjuhës Gjermane)
EVIDENCA 1.19	Kërkesë e UE-së për dhëni e titullit "Doctor Honoris Causa", Prof.Maurizio Giuliani, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i L'Aquila, Itali
EVIDENCA 1.20	Rregullore "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në UE".
EVIDENCA 1.21	Propozim "Për kriteret e pranimit në programet e studimit të UE-së, për vitin akademik 2019-2020.
EVIDENCA 1.22	Strategja e Zhvillimit Institucional 2016-2020, të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.23	Struktura e Personelit Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.24	Vendim SA Nr 16 datë 05.04.2020 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Senatit Akademik të UE"
EVIDENCA 1.25	Vendim SA Nr 15 datë 05.04.2020 "Për miratimin e Kodit të Etikës të UE-së" dhe Rregullorja e Kodit të Etikës në UE
EVIDENCA 1.26	Vendim SA Nr.18 datë 05.04.2020 "Për miratimin e rregullores së studimeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër



39

	Xhuvani"
EVIDENCA 1.27	Model studimi i tregut të punës për programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional "Mekatronikë"
EVIDENCA 1.28	Lista e Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat bashkëpunon Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.29	Lista e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara gjatë vitit akademik 2018-2019 në UE
EVIDENCA 1.30	Financim për rikonstruksion Salla 107 Korpusi kyresor UE
EVIDENCA 1.31	Lista e institucioneve bashkëpunuese qendrore dhe vendore me të cilat bashkëpunon Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 1.32	Vendim SA Nr. 6 datë 30.01.2018 Për krijimin dhe përbërjen e Bordit Editorial të UE-së
EVIDENCA 1.33	Marrëveshja e bashkëpunimit të UE-së me Universitetin e Barit në Itali, UE ka themeluar një revistë elektronike, si produkt kërkimor shkencor i dy institucioneve
EVIDENCA 1.34	Marrëveshje bashkëpunimi midis Institutit "JUNUS EMRE" dhe UE-së
EVIDENCA 1.35	Urdhëri i Rektorit për mënyrën e implementimit të marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit ERASMUS+
EVIDENCA 1.36	Modalitet njohje të periudhave të studimit jashtë vendit
EVIDENCA 1.37	Propozim për angazhimin e Prof. Giovanni Luchena dhe Prof. Gaetano Dammacco si Profesorë të Ftuar në Departamentin e së Drejtës për vitin akademik 2018-2019
EVIDENCA 1.38	Vendim BA datë 23.01.2019 Për caktimin e masës së pagesës së Personelit Akademik për angazhimin në veprimitari kualifikuese- Viti Sabatik
EVIDENCA 1.39	Letër konfirmimi për realizimin e periudhës së mobilitetit, për dy kërkuesit shkencorë turq, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Qendrës së Albanologjisë.
EVIDENCA 2.1	Vendim SA Nr 24 datë 12.04.2020 "Për miratimin e modaliteteve "Për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik në UE"
EVIDENCA 2.2	Model tabele pikëzimi për vlerësimin e personelit akademik në UE
EVIDENCA 2.3	Relacion për organizimin e "Ditëve të informimit të maturantëve"
EVIDENCA 2.4	Konferanca e I-rë Ndërkombëtare në Logopedi dhe Fizioterapi, Elbasan (Shqipëri), qershori 2019
EVIDENCA 2.5	Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Dhurimi Vullnetar Falas i Gjakut", midis UE dhe Kryqi i Kuq Shqiptar, Elbasan
EVIDENCA 2.6	Vendim BA Për pagesën e orëve suplementare të personelit akademik të vitit akademik 2018-2019
EVIDENCA 2.7	Vendim SA Nr 23 datë 12.04.2020 "Për miratimin e rregullores, për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në UE"
EVIDENCA 2.8	Vendimi i UNIBA për personelin akademik të ftuar të UE-së
EVIDENCA 2.9	Vendim i Bordit të Administrimit për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve, në UE, për vitin akademik 2019-2020
EVIDENCA 2.10	Mandat Banke. Kontribut i UE-së për të prekurit nga tërmeti.

The image shows four handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the university officials who signed the document. The signatures are fluid and vary in style. There is also a small number '40' written near the top right of the signatures.

EVIDENCA 2.11	Libri "Social Services in Albania: Background and State of the Art". A report from Tirana, Shkodër and Elbasan.
EVIDENCA 2.12	Marrëveshje me Bashkinë Elbasan për projekt CBHE
EVIDENCA 2.13	Projekt-raport i MASR, mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga UE, për vitin akademik 2019-2020.
EVIDENCA 2.14	Dosje e programit të studimit _ Bachelor në biologji-kimi
EVIDENCA 2.15	Raport final mbi " Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave", për periudhën 16.01.2016 deri më 28.02.2018, të UE-së
EVIDENCA 2.16	Shkresa MASR Nr 1728 datë 02.03.2020 Njoftim për fillimin e angazhimit të Auditit Financiar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 2.17	Vendim SA Nr.25 datë 19.04.2020 Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit në edukim në UE
EVIDENCA 2.18	Dosje e programit të studimit _ Master i Shkencave në Shërbim Prove
EVIDENCA 2.19	Shkresë e AKKSHI për krijimin e Laboratorit Digital të Anatomisë
EVIDENCA 2.20	Lista e pasurive të paluajtshme në përdorim nga UE 2016-2020
EVIDENCA 2.21	Projekti shkencor "Punëtorë të shqar të Albanologjisë"
EVIDENCA 2.22	Lista e mjediseve për personelin akademik dhe veprimtarinë mësimore në UE
EVIDENCA 2.23	Ajenda e aktivitetit të Simpoziumit Jubilar të 110 vjetorit të Shkollës Normale
EVIDENCA 2.24	Shkresa për shpërndarjen e Buletinit Shkencor, në kuadër të botimit të Buletinit Shkencor në UE
EVIDENCA 2.25	Dosje e programit të studimit _ Master Profesional Teknik Imazherie
EVIDENCA 2.26	Investimi në godinën e ish-maternitetit
EVIDENCA 2.27	Akreditimi i Laboratorit Metalurgjik. Certifikatë e akreditimi të Laboratorit Metalurgjik të UE-së
EVIDENCA 2.28	Model-Marrëveshje për praktikat mësimore/ UE-DAR
EVIDENCA 3.1	Formate të broshurave informuese, fletëpalosje UE
EVIDENCA 3.2	Vendim SA Nr 03 datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores së studimeve në UE"
EVIDENCA 3.3	Shkresa për modulet e trajnimit UE
EVIDENCA 3.4	Akreditimi i Konferencës "Konferenca e X Ndërkombëtare në Specialitete" nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, për profesionistët e shëndetësisë
EVIDENCA 3.5	Lista e programeve të studimit që ofrohen nga UE nga Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 3.6	Marrëveshja për Revistën e Barit UE-UNIBA
EVIDENCA 3.7	Model evidencia për organizimin e kohës vjetore të punës
EVIDENCA 3.8	Listë e Laboratoreve të krijuara me të ardhurat e UE 2016-2019
EVIDENCA 3.9	Urdhërat e MASR për hapjen e programeve të reja 2016-2020 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 3.10	Model/ Propozim për hapjen dhe organizimin e programit të ciklit të dytë të studimit (Ekstrakt) Mbrojtje Mjedisë
EVIDENCA 3.11	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze

EVIDENCA 3.12	Kampionati i minifutbollit për fakultete në kuadër të Marrëveshjes mes Federatës Shqiptare të Futbollit-MASR-UE
EVIDENCA 3.13	Trajinimet USAID/ Zbatim i projektit "Drejtësi për të Gjithë", komponenti i medias me USAID
EVIDENCA 3.14	Evidencë për realizimin e orëve mësimore BA&MA nga PAE
EVIDENCA 3.15	Formati i vlerësimit për praktikat mësimore
EVIDENCA 3.16	Manuali për punimin e diplomës të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 3.17	Liste e pedagogëve të ftuar 2016-2020 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
EVIDENCA 3.18	Evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore BA&MA nga PAK
EVIDENCA 3.19	Lista e IAL, me të cilat ka bashkëpunuar UE në kuadër të projekteve përmobilitetet ERASMUS+
EVIDENCA 3.20	Model shembulli i një plani mësimor dhe suplement diplome bachelor/Biologji-Kimi
EVIDENCA 3.21	Lista e mobilitetit të studentëve 2016-2020
EVIDENCA 3.22	Dosje e programit të studimit _Master Profesional në Administrim Biznes
EVIDENCA 3.23	Model shembulli i një plani mësimor dhe suplement diplome Master Profesional/Biologji-Kimi
EVIDENCA 3.24	Ekstrakt i programit të studimit Infermieri-Kirurgjikale
EVIDENCA 4.1	Raportet e pyetësorëve institucionalë dhe vlerësues
EVIDENCA 4.2	Raporti i NJSBC për zhvillimin e pyetësorit institucional, për vitin akademik 2019-2020
EVIDENCA 4.3	Kalendari i analizave të veprimtarisë të njësive kryesore 2018-2019
EVIDENCA 4.4	Dosje e programit të studimit _Sekretar i Specializuar dhe Administrativ
EVIDENCA 4.5	Kontratë qiraje "Për marrjen me qira të mjedisit për zhvillimin e aktivitetit mësimor të Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte
EVIDENCA 4.6	Lista e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara në UE përvitet 2016-2020
EVIDENCA 4.7	Lista me botimet shkencore të stafit të UE
EVIDENCA 4.8	Java e albanologjisë-2019
EVIDENCA 4.9	Marrëveshje me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë
EVIDENCA 5.1	Vendim SA Nr.07 datë 10.04.2019 Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë BA, 2019-2020
EVIDENCA 5.2	Vendimet e Senatit Akademik për kuotat e pranimit në programet e studimit, përvitet 2019-2020
EVIDENCA 5.3	Skedë e realizimit të Ekspeditës mësimore dhe praktika në terren përvitet 2019-2020
EVIDENCA 5.4	Kërkesë nga Departamenti i Gjuhësisë për mbështetjen e ekspositës Shkodra, familja, kultura, historia ime
EVIDENCA 5.5	Praktikë përmblidhjen e të dhënave të ish studentëve të UE të punësuar
EVIDENCA 5.6	Evidencë mbi databzën e gjurmimit të studentëve të UE
EVIDENCA 5.7	Vendimi SA Nr. 13 datë 05.07.2019 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të

Cayr. Amt. ⁴²

- Përhershëm në Nivel Institucional për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës" dhe Rregullorja e Komisionit Vendim KIZ Nr.24 datë 18.06.2019 Për shpalljen fitues për anëtarë të Komisionit të Përhershëm Për mbrojtjen e studentëve në FSHMT Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve për Këshillin Studentor të UE Modaliteti i hapjes së programit të studimit Gjuhë Shqipe dhe Rome Informacion mbi veprimtarinë, funksionimin e bibliotekës online dhe pasurimin e fondit të librit në UE, 2016-2020 Akt-Marrevëshja për "Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar" Model Komisioni Zgjedhor Studentor në Fakultet, me anëtarë studentë Tabela e shpërndarjes së kutive të ndihmës së shpejtë sipas godinave në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Projekt preventiv, shkallë emergjence, godinat e UE Kontratë Publike për Furnizimin e Mallrave "Instalim rrjeti dhe vendosje kamera sigurie në godinat e UE-së" dhe Kontrata Publike për Shërbime "Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes" në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Listë e ish studentë të UE-së të punësuar në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Praktika e ndjekur me Zyrën e Punës për punësimin e studentëve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
- EVIDENCA 5.8
EVIDENCA 5.9
EVIDENCA 5.10
EVIDENCA 5.11
EVIDENCA 5.12
EVIDENCA 5.13
EVIDENCA 5.14
EVIDENCA 5.15
EVIDENCA 5.16
EVIDENCA 5.17
EVIDENCA 5.18



The page contains four handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the committee mentioned in the text above. The signatures are fluid and cursive, with some initials and last names partially legible.